

DEPARTAMENTI I ANTROPOLOGJISË

Doracak për studentë
2020-2021



**DEPARTAMENTI I
ANTROPOLOGJISË
Fakulteti Filozofik**

Doracak për studentë
2020-2021



Ky doracak është përpiluar nga Departamenti i Antropologjisë,
Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
© 2020, Prishtinë (botuar në maj 2020)

Ballina: “Dodolia” si prijëse e thirrësve të shiut në ritin e shiut,
Romajë e Hasit (2009) © Arben Llapashtica

Ky doracak mund të shkarkohet si dokument elektronik në ueb-
faqen e Departamentit të Antropologjisë.
<http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

Përmbajtja

Çka është antropologjia?	7
Çka studion antropologjia kulturore?	8
Çka studion arkeologjia?	9
Dy fjalë rreth historisë së Departamentit	10
Vizioni, misioni dhe qëllimet	11
Cilat janë profilet e studimit në Departamentin e Antropologjisë?	12
Çfarë pritet nga studimet në programin BA në antropologji?	12
Si është i strukturuar programi BA?	13
Si qëndron raporti mes teorisë dhe praktikës?	24
Cilat janë format e mësimdhënies dhe mësimnxënies?	26
Cilat janë obligimet e studentëve në procesin e mësimdhënies?	28
A ka secila lëndë silabus apo planprogram?	28
A ka literaturë të mjaftueshme?	29
A ka bibliotekë Departamenti i Antropologjisë?	30
Disa këshilla për lëndët obligative dhe zgjedhore	31
Cilat janë format e komunikimit mes stafit akademik dhe studentëve?	31
Si organizohet viti akademik dhe kur janë afatet e provimit?	31
Si vlerësohen dhe notohen studentët?	32
Cila është procedura e diplomimit?	34
Si mund të ankohen studentët dhe ku?	35
Si fitohet kushti për studim në vitin vijues?	35
Sa angazhohen studentët në punë praktike?	35
A ka programe shkëmbimi për studentët?	36
Çfarë projektsh hulumtuese, trajnuese dhe praktike ekzistojnë brenda Departamentit?	37
Çfarë përkrahje tjetër profesionale ekziston për studentët?	43
Si përfaqësohen studentët në nivel universiteti?	43
Sa kanë të gjithë studentët mundësi të barabarta?	43
Si monitorohen dhe vlerësohen mësimdhënësit?	44
Cilat janë mundësitë e punësimit të studentëve të diplomuar në Departamentin e Antropologjisë?	44
Cilat janë masat e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit?	45
Si qëndron bashkëpunimi mes studentëve të diplomuar dhe Departamentit?	46
Mendimet e disa studentëve për Departamentin e Antropologjisë	46
Shtojca a) Udhërrëfyes për shkrimin antropologjik	50
Shtojca b) Udhëzime etike për hulumtimin në terren, lejet për intervistë, fotografim dhe incizim	56
Shtojca c) Model i formës së marrjes leje për intervistë, fotografim dhe xhirim	58

Të dashur studentë

Ju që vini për herë të parë, mirë se vini në Departamentin tonë!

Departamenti i Antropologjisë ofron një mundësi unike për të zgjeruar kapacitetin tuaj intelektual, për të njohur traditën e studimit antropologjik mbi kulturën e shoqërinë, për të kalitur konversationin kritik dhe për të ngritur aftësitë tuaja në punë praktike.

Departamenti i Antropologjisë ofron një program studimor në antropologji, unik në rajon e më gjerë, ku ju do të angazhoheni për të studiuar për kulturën e shoqërinë, në kontekst të diversitetit të gjerë kulturor, të botëkuptimeve të shumta e të ndryshme shoqërore, duke e parë atë në kontekstin historik dhe prezentist të saj. Pra, studimet ofrohen në kontekst të antropologjisë kulturore dhe arkeologjisë si dy fusha të studimit të gjerë antropologjik.

Ju do të studioni për kulturat e lashta, për ato antike, për modernitetin, për përvojën e larmishme të vendeve e popujëve në kohë të caktuara, për variantet e ndryshme që përbëjnë kulturën njerëzore, por me fokus të veçantë edhe mbi kulturën shqiptare, për kontekstin e saj historik e social. Gjatë studimeve do të keni mundësi të njiheni me metodat, qasjet, teoritë dhe mendimin kritik antropologjik. Po ashtu, do të keni mundësi të bëni edhe punë praktike, si në kuadër të lëndëve përkatëse brenda programit studimor, ashtu edhe në kuadër të projekteve të shumta që Departamenti ka me institucione të jashtme.

Në këtë doracak do të gjeni përgjigje ndaj shumë pyetjeve që mund të keni tani ose gjatë studimeve tuaja. Shpresojmë të jetë një udhërrëfyes i mirë për ju dhe do t'ju ndihmojë të orientoheni si student të antropologjisë. Të gjithë jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë gjatë studimeve tuaja, kurdo që keni nevojë.

Shpresojmë se do të përfitoni përvojë unike gjatë tri viteve të ardhshme të studimit në këtë Departament dhe kjo përvojë do t'ju jap vetëbesim për të ardhmen tuaj.

Ju urojmë studime të mbara!

Sinqerisht,

Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
Udhëheqës i Departamentit të Antropologjisë

Çka është antropologjia?


Antropologjia është një shkencë dhe dije që studion kulturën njerëzore, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, në të gjitha variantet, format, praktikat, përthyerjet e saj duke përfshirë gjuhën, familjen, racën, gjininë, artin, religjionin, etninë, shtetin, kombin, ligjet, bukën, veshjet, doket, zakonet, traditat etj.

Antropologjia përbëhet nga katër fusha apo degë të veçanta studimi:

- antropologjia kulturore;
- arkeologjia;
- antropologjia linguistike (gjuhësore);
- antropologjia biologjike/fizike.

Në Departamentin e Antropologjisë studentët mund të ndjekin dy nga këto fusha:

- **Antropologjinë kulturore;**
- **Arkeologjinë.**



Çka studion antropologjia kulturore?



Antropologjia kulturore studion marrëdhëniet ndërnjerëzore në kontekst të diversitetit shoqëror e kulturor, me fokus të veçantë në format, praktikat, kuptimet që dalin nga ndryshimet sociale e kulturore. Në kontekst të specializimit të mësimdhënësve të Departamentit, drejtimi i antropologjisë kulturore fokusohet në studimin e marrëdhënieve specifike shoqërore, si variante specifike lokale në kontekst të zhvillimeve globale. Këtu përfshihen studimet e familjes, fotografisë, gjinisë, komunikimit e gjuhës, kulturës buknore, qytetit, fshatit, sigurisë sociale, migrimit, etj. Studentët do të njihen me studimin e

simboleve, praktikave dhe proceseve të ndryshme shoqërore përfshirë ritet, traditat kanunore, trashëgiminë kulturore, kujtesën, raportet e tyre me shtetin, gjininë, globalen, transnacionalen, etj. Fokusi kryesor i Departamentit është të avancojë metodat, qasjen, praktikat e një “antropologjie në shtëpinë tënde”, por gjithnjë në krahasim me studimet e gjëra antropologjike të shoqërive tjera, në rajon dhe botë. Në këtë drejtim studentët kanë përparësi në disa aspekte: puna në terren, puna praktike në institucione, puna në projekte hulumtuese të Departamentit.

Çka studion arkeologjia?



Arkeologjia është shkencë që studion qytetërimet e lashta të shtresuara në kohë dhe hapësirë, duke u bazuar në mbledhjen dhe analizën e gjurmëve të kulturës së tyre materiale. Nga gjurma deri te monumenti, shpeshherë të reduktuara në dromca të shpërndara gjithandej, arkeologët përmes hulumtimeve e vëzhgimeve hedhin dritë mbi të kaluarën historike, që nga parahistoria deri në ditët e sotme. Përmes evidencave të kulturës materiale, arkeologjia synon t'i jep kuptim sistemeve të prodhimit nga materiali deri në produktin final, mënyrave të shfrytëzimit të tyre, braktisjes, ripërdorimit etj, në kontekstin social, shpirtëror, ekonomik, politik.

Studentët e arkeologjisë, pasi të kryejnë vitin e përbashkët (vitin e parë akademik) në antropologji, vijojnë programin e veçantë në arkeologji. Nga viti i dytë studentët e programit të arkeologjisë kanë në fokus mësimin e praktikave dhe proceseve të përgjithshme, lidhur me historikun, zhvillimin, evoluimin dhe karakteristikat e arkeologjisë parahistorike, antike dhe mesjetare, shikuar në hapësira dhe kontekste të gjera dhe të ngushta gjeografike. Po ashtu, rëndësi i kushtohet trajtimit të metodave bashkëkohore të hulumtimeve, studimeve në fushën e arkeologjisë, e cila është e lidhur ngushtë me punën praktike në terren.

Antropologjia linguistike (gjuhësore) merret specifikisht me studimin e gjuhës në kontekst të jetës kulturore e shoqërore.

Ndërsa **antropologjia biologjike/fizike** studion anën biologjike të zhvillimit të kulturës dhe sjelljes shoqërore. Në kuadër të programit të studimit, të disa lëndëve specifike,

studentët inkurajohen të lexojnë studime nga këto dy fusha të antropologjisë. Në të ardhmen, Departamenti i Antropologjisë synon të zhvillojë një program më gjithëpërfshirës të studimit antropologjik, duke marrë parasysh edhe këto dy fusha tejet të rëndësishme.

Dy fjalë rreth historisë së Departamentit

Departamenti i Antropologjisë ekziston që nga viti 2002 dhe është akredituar katër herë. Departamenti i Antropologjisë funksionon në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Në vitin 2002, ky departament është themeluar fillimisht me emërtimin “Departamenti i Etnologjisë”. Nisma për themelimin e tij është marrë nga etnologët e angazhuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës, përkatësisht nga Prof. Dr. Drita Halimi-Statovci. Po ashtu, kontribut të veçantë në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij departamenti ka dhënë, Prof. Dr. Ukë Xhemaj. Në vitet 2005- 2006, Departamenti i Etnologjisë ka ofruar studimet master në Etnologji, të cilat nuk janë akredituar mëtej. Më 2010, Departamenti ka ndryshuar emrin dhe është quajtur: “Departamenti i Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore”, ndërsa nga viti 2014 quhet: “Departamenti i Antropologjisë”. Po këtë vit, janë akredituar edhe dy drejtimet:

- a. Antropologji kulturore;
- a. Arkeologji.

Në vitin 2017, Departamenti i Antropologjisë është akredituar për 5 vite, me

dy programe siç e theksuam më lartë. Gjatë kësaj periudhe në Departamentin e Antropologjisë kanë diplomuar mbi 300 studentë, shumica e të cilëve punojnë në institucione të ndryshme shtetërore të kulturës, trashëgimisë kulturore, sektor të ndryshëm të biznesit, shoqërisë civile etj. Prej themelimit më 2002 e deri më tani, Departamenti i Antropologjisë ka realizuar mbi 80 vizita në terren, 20 projekte të përbashkëta hulumtuese, mbi 50 ligjërata të profesorëve vizitorë, mbi 20 ekspozita të departamentit, e një numër të madh aktivitete hulumtuese në fushën e antropologjisë.

Më 2013, pranë Departamentit është themeluar edhe “Arkivi i Fotografisë dhe Videos”, ndërsa më 2017 edhe “Programi i Etnografisë Vizuele”. Më 2018, Departamenti i Antropologjisë ka themeluar edhe “Seminarin e Antropologjisë”, një program me ligjërata të profesorëve vizitorë (8 muaj në vit) nga studiues të jashtëm dhe të brendshëm dhe me aktivitetet tjera periodike.

Departamenti i Antropologjisë ka profesorë, asistentë, ligjërues të rregullt dhe angazhuar, shumica e të cilëve kanë kryer studimet në fushën e antropologjisë kulturore, arkeologjisë, historisë, gjuhës, e shkencave

tjera shoqërore, në vend e universitete të ndryshme perëndimore. Departamenti i Antropologjisë bashkëpunon me një numër të madh të

partnerëve vendor, ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe promovimit të antropologjisë si shkencë e dije.

Vizioni, misioni dhe qëllimet

Departamenti ka si vizion avancimin e mendimit antropologjik shqiptar. Misioni i departamentit është kultivimi i mendimit antropologjik duke ofruar njohuri themelore mbi kulturën, shoqërinë, për të kaluarën, të tashmen, përmes ligjërimit, mësimi, trajnimit e hulumtimit. Departamenti i Antropologjisë aplikon një gamë të gjërë të qasjeve teorike e praktike për të studiuar kulturën dhe shoqërinë, në kontekst lokal, regjional, global, dhe në linjë me shumë debate klasike dhe bashkëkohore brenda arkeologjisë, antropologjisë, shkencave shoqërore, dijeve humane në përgjithësi.

Qëllimet kryesore të departamentit janë si vijon:

- të ofrojë programe themelore (BA) dhe pasdiplomike (MA) të studimit në fushën e antropologjisë;
- të realizojë projekte hulumtuese;
- të ofrojë kurse trajnuese, profesionale, praktike,
- të organizojë konferenca, seminare, tryeza, aktivitete të tjera akademike.

Cilat janë profilet e studimit në Departamentin e Antropologjisë?

Kandidatët që aplikojnë për t'u regjistruar në Departamentin e Antropologjisë mund të zgjedhin njërin nga dy drejtimet e antropologjisë:

- Antropologji kulturore;
- Arkeologji.

Në vitin e parë, përkatësisht në dy semestrat e parë, dominojnë lëndë me përmbajtje të përgjithshme për të dyja programet. Në semestrin e tretë, studentët profilizohen sipas zgjedhjes së tyre në programet përkatëse. Studentët mund të ndryshojnë drejtimin e tyre të studimit në fund të vitit të parë, duke bërë kërkesë me shkrim, e cila pasi pranohet nga udhëheqësi

i departamentit lipset të aprovohet nga Komioni i Studimeve dhe Këshilli i Fakultetit Filozofik.

Pas përfundimit të vitit të parë akademik, i konceptuar si një fazë hyrëse ku kombinohen njohjet bazike në fushën e antropologjisë, si asaj kulturore dhe arkeologjisë, studentët profilizohen në drejtimin e zgjedhur paraprakisht. Studentët njoftohen me premiset, kahet, qasjet, metodat, teoritë kryesore të fushës, përfshirë historinë e saj. Plani mësimor përbëhet nga lëndë të cilat janë disenjuar të ndërveprojnë njëra me tjetrën në mënyrë që të reflektojë vizionin e qëllimet e departamentit.

Çfarë pritet nga studimet në programin BA në antropologji?

Siç është thënë më lartë, në vizionin, misionin e Departamentit të Antropologjisë, përmes këtij programi do të avancohet mendimi dhe hulumtimi antropologjik shqiptar.

Programi themelor në BA pritët të ofrojë përgatitje akademike dhe profesionale për studime antropologjike të kulturës njerëzore, duke u bazuar në metoda, qasje e teori pluraliste të studimit antropologjik, që aplikohen në universitete perëndimore. Për më tepër, nëse ndiqet me sukses programi i profilizuar, studentët e antropologjisë priten të marrin njohuri specifike në planifikimin e projekteve hulumtuese në antropologji kulturore dhe arkeologji.

Pas përfundimit me suksese të studimeve të nivelit themelor (bachelor), studentët do të jenë të aftë, që në mënyrë të pavarur, grupe, të realizojnë studime profesionale në fushën e antropologjisë kulturore dhe arkeologjisë. Po ashtu, ata do të aftësohen të menaxhojnë projekte hulumtuese, të ofrojnë këshilla profesionale për institucione të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe të fushës së industrisë kreative kulturore. Studentët do të inkurajohen të mendojnë në mënyrë të lirë dhe kritike, duke respektuar parimet e lirisë akademike dhe pluralitetin e diversitetin e mendimit akademik.

Po ashtu, studentët që i përfundojnë me sukses studimet parashihet të marrin këto aftësi dhe shkathtësi profesionale:

- aftësinë për të identifikuar, hulumtuar, interpretuar, krahasuar marrëdhëniet shoqërore dhe kulturore, në kontekst ndryshimit nga e kaluara deri te sotmja;
- aftësinë e realizimit të hulumtimit, shkrimit etnografik, arkeologjik të bazuar në evidenca, refleksion, dhe në baze të parimeve etike për metodat dhe qasjet bashkëkohore në antropologji;
- aftësinë për të planifikuar, për të bërë gërmime arkeologjike, duke përfshirë kategorizimin, dokumentimin, përshkrimin, analizimin e objekteve të së kaluarës;
- aftësinë t'a interpretojnë kulturën materiale të së kaluarës, së tashmes, nën dritën e debateve aktuale antropologjike dhe arkeologjike;
- aftësinë analitike, kritike të te kuptuarit të teksteve, materialeve, ideve antropologjike;
- aftësinë të diskutojnë në mënyrë kritike aspektet e kulturës e diversitetit kulturor në sferën publike dhe private;
- përgatitjen profesionale në hulumtim, interpretim, menaxhimin e trashëgimisë kulturore, në kontekst krahasimtar;
- përgatitjen profesionale në këshilldhënie dhe menaxhim në institucione, organizata të ndryshme, duke përfshirë sektorin privat, publik dhe jo-fitimprurës;
- përgatitjen profesionale në përpilimin e projekteve hulumtuese, mbledhjen e historive gojore, përpilimin e dokumenteve strategjike të institucioneve kulturore, kuratorinë në koleksionet e trashëgimisë, hulumtimin dhe hartëzimin e lokacioneve arkeologjike, prodhimin e filmave dhe fotografive etnografike;
- aftësinë për t'u angazhuar në projekte bashkëpunuese interdisiplinare me shkencat tjera shoqërore, humane dhe zhvillime teknologjike.

Si është i strukturuar programi BA?

Siç u theksua më lartë, programi i studimeve për vitin e parë është i përbashkët për të dyja drejtimet, kurse në vitin e dytë dhe të tretë është i veçantë. Ai, përbëhet nga lëndë obligative dhe zgjedhore. Përpos semestrit të parë ku janë paraparë pesë lëndë obligative dhe asnjë zgjedhore, në semestrat vijues të secilit vit, programi ofron lëndë obligative dhe zgjedhore për secilin semestër.

Nga lëndët e ofruara zgjedhore, studentët duhet të zgjedhin një të një prej tyre. Lëndët zgjedhore janë po aq të rëndësishme sa edhe ato obligative.

Në fund të semestrit të VI, studentët duhet të zgjedhin dhe punojnë temën e diplomës të cilën e mbrojnë para një komisioni të përbërë prej tre profesorëve.

VITI I PARË - Semestri I

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Hyrje në antropologji	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Nita Luci
2	Hyrje në arkeologji	3+2	6	Ass. Pleurat Kabashi
3	Shkrimi akademik	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani
4	Etnolinguistikë	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani
5	Histori e qytetërimeve	3+2	6	Prof. Dr. Edi Shukriu
	Gjithsej	15+10	30	

VITI I PARË - Semestri II

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Etnologji shqiptare	3+2	6	Ass. Zanita Halimi, doktorante
2	Histori ilire	3+2	6	Dr. Sedat Baraliu
3	Muzetë dhe ekspozimi i kulturës	3+2	7	Ass. Zanita Halimi, doktorante
4	Struktura dhe organizimi shoqëror	3+2	6	Dr. Tahir Latifi

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Kulturë ilire	2+2	5	Ass. Pleurat Kabashi, doktorant
2	Antropologji e religjionit	2+2	5	Prof. Asc. Dr. Muhamet Mala
3	Histori e artit	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Florina Jerliu
	Gjithsej	14+10	30	

DREJTIMI ANTROPOLOGJI KULTURORE**VITI I DYTË - Semestri III**

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Studimet e familjes në perspektivë krahasuese	3+2	6	Dr. Tahir Latifi
2	Antropologji e së drejtës dhe ligjit	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
3	Kultura dhe edukimi	3+2	7	Ass. Zanita Halimi, doktorante
4	Antropologji e gjinisë	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Nita Luci

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Kërkimi dhe shkrimi etnografik	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
2	Histori moderne botërore	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Albina Drançolli
3	Shoqëria dhe mjedisi	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani
	Gjithsej	14+10	30	

VITI I DYTË – Semestri IV

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Antropologji e ushqimit	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
2	Antropologji urbane	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Nita Luci
3	Metodat dhe teknikat e hulumtimit	3+2	7	Dr. Tahir Latifi
4	Teoritë etnologjike dhe antropologjike	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Filmi etnografik	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
2	Veshjet dhe identiteti	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
3	Antropologji e krijimtarisë dhe memories	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Nita Luci
	Gjithsej	14+10	30	

VITI I TRETË - Semestri V

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Trashëgimia kulturore	3+2	7	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
2	Antropologji vizuale	3+2	6	Ass. Zanita Halimi, doktorante
3	Antropologji e shtetit	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Nita Luci
4	Migrimi dhe siguria sociale	3+2	6	Dr. Tahir Latifi
	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Histori mesjetare e Evropës Juglindore	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj-Camaj
2	Artet tradicionale	2+2	5	Dr. Lumniye Kadriu
3	Udhëpërshkrimi dhe etnografia	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
	Gjithsej	14+10	30	

VITI I TRETË – Semestri VI

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Antropologji e Evropës Juglindore	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Nita Luci
2	Mediat dhe kultura	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani
3	Menaxhimi i trashëgimisë kulturore	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani
4	Punim Diplome	0+5	7	
	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Rritet në kohë dhe hapësirë	2+2	5	Dr. Lumniye Kadriu
2	Kultura materiale dhe konsumi	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli
3	Kultura e ndërtimit dhe banimit	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Nita Luci
	Gjithsej	14+10	30	
	Gjithsej	145	180	

DREJTIMI ARKEOLOGJI

VITI I DYTË - Semestri III

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Arkeologji e kohës së gurit	3+2	6	Prof. Dr. Edi Shukriu
2	Arkeologji e kohës së metaleve	3+2	6	Dr. Sedat Baraliu
3	Metodat e hulumtimeve arkeologjike	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari
4	Arkeologji e Europës Jug-lindore	3+2	7	Ass. Pleurat Kabashi, doktorant

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Historia dhe kultura shqiptare	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Selim Bezera
2	Gjuhë latine	2+2	5	Prof. Assoc. Dr. Evalda Paci
3	Paleografi	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari
	Gjithsej	14+10	30	

VITI I DYTË - Semestri IV

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Histori antike	3+2	6	Prof. Dr. Edi Shukriu
2	Arkeologji antike	3+2	7	Prof. Assoc. Dr. Belisa Muka
3	Antropologji e Religjioneve	3+2	6	Prof. Assoc. Muhamet Mala
4	Kulturë provinciale romake	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari
	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Trashëgimia kulturore dhe mjedisi	2+2	5	Ass. Pleurat Kabashi, doktorant
2	Hapësirat sakrale në Kosovë	2+2	5	Dr. Sedat Baraliu
3	Burimet literare antike greke dhe latine	2+2	5	Ass. Pleurat Kabashi, doktorant
	Gjithsej	14+10	30	

VITI I TRETË - Semestri V

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Arkeologji ilire	3+2	7	Dr. Sedat Baraliu
2	Arkeologji mesdhetare	3+2	6	Ass.Pleurat Kabashi, doktorant
3	Arkeologji mesjetare	3+2	6	Prof. Dr. Luan Përzhita
4	Epigrafi dhe numizmatikë	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Dokumentimi në arkeologji	2+2	5	Ass. Pleurat Kabashi, doktorant
2	Numizmatikë ilire	2+2	5	Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari
3	Arkitektura ilire	2+2	5	Dr. Sedat Baraliu
	Gjithsej	15+10	30	

VITI I TRETË – Semestri VI

	Lëndët obligative	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Arkeologji dardane	3+2	6	Prof. Dr. Edi Shukriu
2	Arkeologji mesjetare ballkanike	3+2	6	Prof. Dr. Luan Përzhita
3	Histori mesjetare e Europës	3+2	6	Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj
4	Punim diplome	0+5	7	

	Lëndët zgjedhore (zgjedhet një)	Ligj/Usht	ECTS	Mësimdhënësi
1	Arti grek dhe romak	2+2	5	Dr. Sedat Baraliu
2	Mitologji	2+2	5	Ass. Pleurat Kabashi, doktorant
3	Gjuhë e huaj (Angleze, Frënge, Gjermane)	2+2	5	Ligjërues nga Fakulteti Filologjik
	Gjithsej	15+10	30	
	Gjithsej	145	180	

Udhëheqësi i Departamentit

Udhëheqësi i Departamentit të Antropologjisë udhëheq me departamentin në cilësinë e drejtuesit të tij, duke qenë kështu përgjegjës për udhëheqjen, mbikqyrjen, realizimin e vizionit, misionit, qëllimeve dhe komunikimin mes departamentit dhe instancave të tjera të universitetit, si dekanati, rektorati. Udhëheqësi i departamentit është adresa e parë e kontaktit si për studentët, stafin e Departamentit të Antropologjisë, po ashtu dhe për ata, që mund të kenë interesim të bashkëpunojnë me Departamentin e Antropologjisë. Ai, përfaqëson departamentin në mbledhjet e Fakultetit, respektivisht Universitetit, thërret dhe drejton mbledhjet e brendshme të departamentit. Po ashtu, udhëheqësi i Departamentit të Antropologjisë, kujdeset për mbarrëvajtjen e veprimtarive akademike, studentore të Departamentit të Antropologjisë, duke shërbyer si një hallkë mes fakultetit dhe degëve e hallkave të tjera të Universitetit të Prishtinës.

*Udhëheqës i Departamentit
të Antropologjisë është:
Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli*

Sekretari i Departamentit

Sekretari i Departamentit të Antropologjisë ndihmon udhëheqësin e departamentit në menaxhimin dhe mbarrëvajtjen e punëve të departamentit dhe në mungesë të tij, e zëvendëson atë. Sekretari është përgjegjës, ndër të tjera, për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, vendimeve të departamentit, të listës së të diplomuarve dhe të studentëve që janë në proces të diplomimit. Pas udhëheqësit, sekretari është personi i dytë zyrtar të cilit mund t'i drejtohen studentët për konsultime rreth orareve të ligjëratave apo provimeve si dhe nevojave të tyre në përgjithësi.

*Sekretar i Departamentit të
Antropologjisë është:
Ass. Durim Abdullahu, doktorant*

Mësimdhënësit e rregulltë dhe të angazhuar

Në Departamentin e Antropologjisë japim mësim profesorët, asistentët dhe ligjëruesit e angazhuar.

Kontakti zyrtar i Departamentit është: **antropologjia@uni-pr.edu**

Mësimdhënësi	Zyra	Adresa elektronike
Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari Arben Hajdari është profesor i arkeologjisë në Departamentin e Antropologjisë. Studimet BA i ka të përfunduara në Universitetin e Prishtinës, kurse ato të nivelit MA dhe PhD në Universitetin Pierre Mendes France, Grenoble II (Francë) në fushën e arkeologjisë dhe historisë antike. Fushë të specializimit ka periudhën romake me fokus në çështjen e romanizimit (akulturimit). Merret gjithashtu me epigrafi dhe numizmatikë. Është autor i disa eseve të botuara brenda dhe jashtë vendit.	20	arben.hajdari@uni-pr.edu
Prof. Ass. Dr. Nita Luci (MA/PhD Antropologji, Universiteti i Miçiganit "En Arbor", SHBA), ligjeron në Departamentet e Antropologjisë, Sociologjisë, Artit Konceptual në Universitetin e Prishtinës. Ajo ligjeron dhe hulumton rreth temave të nacionalizmit, burrërisë dhe shtetit në kontekste të post-socializmit dhe post-kolonializmit. Fushat e interesit të saj akademik ndërthuren me praktika të angazhimit shoqëror në fushën e barazisë gjinore, artit dhe aktivizmit, kujtesës dhe hapësirave publike. Më 2014 e bashkëthemeloi Programin Universitar për Studime dhe Hulumtime Gjinore në Fakultetin Filozofik, në UP.	304	nita.luci@uni-pr.edu
Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli Arsim Canolli ka kryer studimet në Mbretëri të Bashkuar, ku edhe doktoroi në antropologji (UCL). Interesimi i tij është në kulturën buknore, materiale, trashëgiminë kulturore, teoritë antropologjike, të drejtën zakonore, histori të mendimit etnologjik, folklor, etj. Libri i tij i fundit është <i>Shënime nga biblioteka</i> (2019). Ende i ka hobi ecjet në mal dhe bukën e mirë.	121	arsim.canolli@uni-pr.edu
Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj Camaj, profesoreshë në Departamentin e Antropologjisë, ku ligjeron lëndët: Epigrafi dhe Numizmatikë, Histori mesjetare e Evropës dhe Histori mesjetare e Evropës Juglindore. Fusha e studimit të saj është e fokusuar në Antikitetin e vonë dhe Mesjetën e hershme. Ka të botuara disa punime shkencore, brenda dhe jashtë vendit.	21	kujtime.boshtrakaj@uni-pr.edu

Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani Arsim Sinani profesor i etnolinguistikës, shkrimit akademik, mediave e kultura, menaxhimi i trashëgimisë kulturore, në Departamentin e Antropologjisë. Doktoroi në Universitetin e Tiranës, në trajtimin e problemeve të gjuhës shqipe në Maqedoninë e V. Monografia “(Mos)zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë” një studim lingustik botuar nga UET Press. Ka pasion Malin Sharr, traditat, ritet e vjetra, arkivat. Editor i revistës shkencore “Diskutime”, themelues i Festivalit etnokulturor “Sofra fest”. Ka dy ekspozita të përhershme në Muzeun e Alfabetit në Manastir. Drejtor i Institutit për studime sociale e humanistike ISSH, në Fakultetin Filozofik të UP-së.	118	arsim.sinani@uni-pr.edu
Dr. Sedat Baraliu Sedat Baraliu është ligjërues i arkeologjisë në Departamentin e Antropologjisë. Ka mbaruar studimet BA në Universitetin e Prishtinës, kurse ato në nivelit MA dhe PhD në Universitetin Pierre Mendes France (Francë), në fushën e arkeologjisë dhe historisë antike. Fushë të ngushtë të specializimit e ka periudhën e hekurit, me fokus të veçantë praktikën dhe ritet funerale. Është autor i disa eseve të botuara brenda dhe jashtë vendit.	20	Sedat.baraliu@uni-pr.edu
Ass. MA. Pleurat Kabashi, doktorant Pleurat Kabashi është mësimdhënëse në Departamentin e Antropologjisë. I ka kryer studimet bazike në “Universitetin e Prishtinës”, magjistraturën në Universitetin “Pierre Mendes France”, në Grenoble të Francës, është në proces të përfundimit të studimeve doktoale në Universitetin «Lumiere Lyon 2”, në Lion të Francës. Fokusi i studimeve të tij prek periudhën antike, me theks të veçantë periudhën romake. Merret me trashëgimi kulturore dhe gërmime arkeologjike.	20	pleurat.kabashi@uni-pr.edu
Ass. MA. Durim Abdullahu, doktorant Durim Abdullahu është asistent dhe sekretar në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës. Studimet (BA, MA) në histori i ka kryer në Universitetin e Prishtinës, ku është edhe doktorant. Fushat e interesit të tij: kultura mesjetare e Ballkanit Perëndimor, identiteti i arbërve në veçanti, historia e përditshmërisë së shqiptarëve gjatë modernitetit të vonë, antropologjia e gjuhës dhe religjionit, mediat e kultura. Botimi i tij i fundit është: “Myth and Mythical Spaces: Conditions and Challenges for History Textbooks in Albania and South-Eastern Europe” (Göttingen: 2018)	123	durim.abdullahu@uni-pr.edu

Ass. MA Zanita Halimi, doktorante Zanita Halimi është doktorante e antropologjisë në Universitetin e Vjenës. Me studentët e Departmentit të Antropologjisë ka realizuar disa ekspozita etnografike, video dokumentuese, që në fokus ka ritualet në Kosovë. Ka të botuar disa ese antropologjike për etnologjinë shqiptare, antropologjinë vizuale e muzeologjinë. Aktualisht është në përgatitje të librit të saj të parë në fushën e antropologjisë kulturore. Ajo kryeson Programin për Etnografi Vizuale.	122	zanita.halimi@uni-pr.edu
Prof. Dr. Edi Shukriu Akademik Edi Shukriu është profesoreshë e arkeologjisë në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Antropologjisë. I ka përfunduar studimet për arkeologji në Beograd (BA dhe MA) kurse ato të doktoratës në shkencat historike në Universitetin e Prishtinës. Fushë të ngushtë të interesit e ka periudhën e metaleve me fokus në kulturën dardane. Është e para arkeologe femër në Kosovë, njëherit themeluese e programit të arkeologjisë. Ka botuar një numër monografish dhe punimesh shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit.		
Dr. Tahir Latifi Tahir Latifi i ka kryer studimet e doktoraturës në Universitetin e Graz-it (Austri), Qendra për Histori dhe Antropologji e Evropës Juglindore. Nga tetori i 2015-ës është ligjërues në Departamentin e Antropologjisë. Ai është i fokusuar në studime dhe hulumtime për familjen, farestinën, politikat sociale, migrimin, demografinë, të drejtën zakonore, ndryshimet socio-kulturore. Botimi i tij i fundit është: 'Generational and intergenerational care and mobility networks in Kosovo', në <i>Südosteuropa. Journal of Politics and Society</i>, vol. 67 (2); 2019	124	tahir.latifi@uni-pr.edu
Ass. MA Arianit Buqinca, doktorant Arianit Buqinca i ka kryer studimet universitare në histori në Universitetin e Prishtinës, ndërsa ato MA në Universitetin Lumière Lyon 2 në Lion të Francës, ku po i ndjek studimet e doktoratës për gjuhë, histori dhe civilizim, koha e vjetër. Ai është hulumtues i pavarur shkencor për histori të kohës së vjetër në Institutin Albanologjik. Nga vitit 2015 ligjëron në Departamentin e Antropologjisë. Ka realizuar hulumtime specializuese, hulumtuese në terren që nga viti 2007 në Romë, Ulpianë, Butrint, Apolloni, Kasterc, Vuçak, Harilaq etj. Ka marrë pjesë me kumtesa në konferenca dhe simpoziume vendore dhe ndërkombëtare.	20	arianit.buqinca@uni-pr.edu

Ass. Yilka Syla Bashkëpunëtore asistente në Fakultetin Filozofik, departamenti i Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës. I ka kryer studimet Bachelor në Universitetin e Prishtinës, në Departamentin e etnologjisë dhe psikologjisë. Masterin në etnologji dhe folklor në Qendrën e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, në Tiranë. Fushat e interesit: antropologjia e kanunit, antropologjia e së drejtës dhe ligjit, migrimet, etnopsikologjia.	117	
Dr. Lumnije Kadriu Lumnije Kadriu është Bashkëpunëtore Shkencore në Institutin Albanologjik, Dega e Etnologjisë, Prishtinë. Titullin Doktor në Shkenca e fitoi në Institutin për Etnologji Evropiane, në Universitetin e Vjenës. Që nga viti 2011 ligjëron në Departamentin e Antropologjisë. Monografia e saj e fundit është: <i>"Pushimet, familja, vendlindja në praktikën e diasporës shqiptare të Kosovës"</i> (2017). Interesimet e saj janë të lidhura me traditën e ndërlidhur në procesin e globalizimit dhe çështjet transnacionale.	/	lumnije.kadriu@uni-pr.edu
Prof. Ass. Dr. Florina Jerliu Florina Jerliu është profesore e arkitekturës në Fakultetin e Arkitekturës/UP. Studimet doktorale i ka kryer në Sarajevë me temë mbi qytetin historik urban. Hulumtimet e saj kryesore janë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe urbanizmit. Ka shërbyer në borde drejtuese të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe ka hartuar plane e strategji të shumta në këtë fushë. Libri e saj e fundit është <i>Trashëgimia Kulturore e Kosovës: Konceptet dhe Kontekstet e Mbrojtjes</i> , 2017.	/	florina.jerliu@uni-pr.edu
Prof. Asoc. Dr. Belisa Muka Belisa Muka është kërkuese shkencore, që prej vitit 2000, në Departamentin e Antikitetit, Instituti i Arkeologjisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike. Studimet doktoratorale i ka kryer në Universitetin Lille 3 Charles - De - Gaulle (Francë) në fushën e arkeologjisë klasike. Fusha e saj e specializimit lidhet ngushtësisht me Koroplastinë, Arkeologjinë e religjionit dhe Arkeologjinë e jetës ekonomike	/	belisa.muka@uni-pr.edu
Prof. Asoc. Dr. Evalda Paci Prof.Asoc.Dr.Evalda Paci është kërkuese shkencore në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë. Interesat e saj studimore orientohen ndaj teksteve të vjetra shqipe dhe studimit filologjik e kritik të tyre, letërsisë së vjetër shqipe (shek.XVI-XVII) dhe historisë së gjuhës latine. Që nga viti 2014 ligjëron në Departamentin e Antropologjisë. Libri i saj i fundit është <i>Studime mbi tekstet e vjetra shqipe</i> , Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017	/	evaldapaci@gmail.com

Ass. MA Ilir Culaj, doktorant Ilir Culaj është asistent i arkeologjisë në Departamentin e Antropologjisë. Studimet BA i ka përfunduar në “Universitetin e Prishtinës”, kurse ato të nivelit MA në Universitetin “Lumière-Lyon-II” të Francës. Aktualisht është duke ndjekur studimet doktorale në “École normale supérieure” (Paris) për arkeologji dhe histori të kohës antike. Fokusi i tij i studimeve përfshin periudhën romake, me theks të veçantë religjionin romak dhe epigrafinë latine.	/	Ilir.culaj@uni-pr.edu
---	---	-----------------------

Personeli administrativ

Personeli administrativ ndihmon stafin dhe studentët e antropologjisë në mbarëvajtjen e mësimdhënies e mësimnxënies në Departament. Personeli administrativ kujdeset për procedurat e regjistrimit, përgatitjen e profilit studentor në sistemin e menaxhimit të të dhënave, kujdeset për sistemin e menaxhimit elektronik (SEMS) dhe analog të provimeve etj.

Personeli	Pozita	Zyra	Adresa elektronike
Shkurte Arifaj	referente e Departamentit të Antropologjisë	02	shkurte.arifaj@uni-pr.edu
Mentor Maka	zyrtar i TIK-ut	110	mentor.maka@uni-pr.edu
Agim Hyseni	zyrtar i arkivit	10	agim.hyseni@uni-pr.edu
Lumnije Ahmeti	sekretare e Fakultetit Filozofik	16	lumnije.ahmeti@uni-pr.edu
Ibrahim Hoxha	zyrtar për mësim	15	ibrahim.hoxha@uni-pr.edu
Ardita Beshiri	zyrtare për bibliotekë		ardita.beshiri@uni-pr.edu

Si qëndron raporti mes teorisë dhe praktikës?

Departamenti i Antropologjisë kultivon e promovon studimin e bazuar në qasje të kombinuar teorike dhe praktike.

Puna praktike është pjesë përbërëse e planprogramit të dy profileve. Plan mësimor parasheh organizim të vazhdueshëm të punës në terren, që prezantohet përmes seminareve, performancave, vizitave vrojtuese e intervistuese në terren, përnjohjeve, gërmimeve arkeologjike, restaurimit, konservimit, fotografimit, filmimit, ekspozitave dhe aktiviteteve tjera. Studentët inkurajohen të prezantojnë punën e tyre me publikime, ekspozita

etj, në hapësirat publike brenda e jashtë UP-së, si në muze, galeri, institute, media, forume ndërkombëtare. Gjatë studimeve studentët do të marrin njohuri në zhvillimin e argumentimit dhe analizës teorike të evidencës empirike. Këto njohuri do të jepen përmes ligjëratave dhe seminareve, por edhe në proces të zhvillimit të hulumtimit, shkrimit dhe vlerësimit. Studentët do të jenë në gjendje të diskutojnë për konceptet, argumentimin, qasjen, teorinë e metodat e ndryshme në kontekst të mendimit kritik në fushën e antropologjisë, duke ekzaminuar edhe evidencën e vjetër në kontekst të argumenteve



të reja por edhe argumentet e vjetra në kontekst të evidencës së re. Studentët do të inkurajohen të lexojnë dhe të diskutojnë leximet e tyre me kolegë e profesorë gjatë ligjëratave, seminareve, aktiviteteve tjera, sepse leximet janë esenciale për zhvillimin e argumentit teorik në raport me evidencën e re empirike.

Si një nga prioritetet e veta, Departamenti e konsideron ngritjen e aftësive dhe kompetencave për hulumtim (të studentëve, të diplomuarëve, dhe asistentëve).

Departamenti i jep përkrahje të vazhdueshme akademike të diplomuarve në programet e departamentit. Përkrahja nënkupton konsultimin, mentorimin për avancim akademik, identifikimin dhe përgaditjet për vazhdim të studimeve, përfshirjen potenciale të atyre që diplomojnë në projekte hulumtuese (punë në terren, si asistent në hulumtim, pjesëmarrje në konferenca, punëtori, shkolla verore etj.)



Cilat janë format e mësimdhënies dhe mësimnxënies?

Mësimdhënia dhe mësimnxënia bëhen përmes ligjëratave, seminarve, ushtrimeve, konsultimeve, projekteve hulumtuese (*terren, laboratore*) dhe leximit, diskutimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm gjatë studimeve.

Ligjëratat



Ligjëratat janë orë leksionesh të drejtuara nga profesorë përkatës që i mbajnë ato lëndë, në të cilat studentëve u ligjërojnë në intervale javore për çdo lëndë. Gjatë ligjëratave, të cilat studentët janë të obliguar t'i përcjellin rregullisht, studentët njihen me përmbajtjen e lëndëve të parapara në programin e studimeve. Në fillim të çdo semestri, studentët marrin një planprogram/silabus të lëndës nga profesorët që bartin lëndët, përmes së cilit studentët njihen me përmbajtjen e ligjëratave gjatë 15 javëve, në njërin semestër. Në kuadër të ligjëratave,

studentët kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre, t'u parashtrojnë pyetje profesorëve në lidhje me temat që ligjërohen si dhe të kërkojnë sqarime shtesë në rast se kanë probleme të kuptojnë, apo të nxënë idetë, metodat, praktikat dhe teoritë që u ligjërohen. Aktiviteti dhe pjesëmarrja e studentëve në ligjëratat si angazhim, evidentohen, vlerësohen nga profesorët dhe përfshihen në notimin përfundimtar të studentëve. Profesorët janë të obliguar t'i përmbahen përmbajtjes së silabusëve përkatës.



Ushtrimet

Ushtrimet janë orë mësimore të strukturuar si pjesë përcjellëse të ligjëratave, të cilat rëndom mbahen nga asistentët e departamentit. Në ushtrime, të cilat studentët janë të obliguar t'i përcjellin rregullisht, praktikohen qasje e metoda të ndryshme ku studentët mësojnë dhe njëkohësisht i testojnë njohuritë e tyre. Për dallim nga ligjëratat, ku koha më e madhe u takon profesorëve, ushtrimet janë paraparë si mundësi për më shumë komunikim, dialog e punë praktike

mes studentëve dhe asistentëve.

Në ushtrime mund të vijnë më shumë në shprehje idetë dhe mendimet e studentëve, ku komunikimi ndërmjet vetë studentëve dhe asistentëve është i drejtpërdrejtë. Seminaret dhe detyrat, studentët rëndom i prezantojnë dhe diskutojnë me asistentë dhe studentët e tjerë pikërisht gjatë ushtrimeve, për çka ata vlerësohen, vlerësim ky që përpjestohet me notimin përfundimtar.

Konsultimet

Secili profesor dhe asistent, ka një orar prej katër orësh në javë, të ndarë për të pritur në zyret e tyre studentët në konsultime. Oraret e konsultimeve paraqiten në dyer të zyrave të secilit profesor. Gjatë orarit të konsultimeve studentët mund të bisedojnë ballazi me profesorët dhe asistentët për aktivitetet në ligjëratat dhe ushtrime si dhe për detyrat dhe obligimet e tyre.

Studentët mund t'a konsultojnë një për një personelin akademik për çfarëdo që ata ndjejnë nevojë në aspektin akademik, e veçanërisht për temat që diskutohen gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, për librat apo tekstet që kërkohen të lexohen, detyrat, seminaret.

Projektet hulumtuese

Departamenti i Antropologjisë realizon projekte të ndryshme akademike nga fusha antropologjike dhe arkeologjike, në të cilat parashihet përfshirja e studentëve. Në kuadër të këtyre projekteve, studentët aftësohen për hulumtime, punë praktike në terren dhe shkrim akademik. Puna e studentëve në projektet e Departamentit të Antropologjisë bëhet nën drejtimin e personelit akademik dhe në bashkëpunim me ta. Kjo punë dhe

rezultatet e saj vlerësohen dhe përfshihen në notimin e studentëve. Ndër këto projekte janë marrëveshjet për shkëmbim të studentëve drejt universiteteve të tjera dhe ndihma që profesorët u ofrojnë studentëve për të arritur bursa për studime në universitete jashtë vendit.

(Për më shumë shih më poshtë sqarimet për projekte).

Cilat janë obligimet e studentëve në procesin e mësimdhënies?

Studentët janë të obliguar të marrin pjesë rregullisht në orët e ligjëratave dhe ushtrimeve. Përcjellja e ligjëratave dhe përfshirja në seminare gjatë ushtrimeve është boshti që e mban ritmin e angazhimit të vazhdueshëm të studentëve gjatë tërë semestrit. Dëgjimi i ligjëratave dhe ushtrimi i

çështjeve të tematizuara prej tyre, janë ndër temat kryesore të studimit. Nga këtej, studentët vlerësohen dhe notohen për pjesëmarrjen, aktivitetin, angazhimin, autenticitetin e punës së tyre. Përmes ligjëratave dhe detyrave synohet formimi sa më i plotë profesional i studentëve.

A ka secila lëndë silabus apo planprogram?

Secili bartës i lëndës është i obliguar t'a përpilojë silabusin apo planprogramin e lëndës, sipas kërkesave të përgjithshme të cilat jepen nga Universiteti i Prishtinës, po ashtu kërkesa këto të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Profesorët janë të lirë të zgjerojnë silabusin e tyre në fusha ku ata e shohin të arsyeshme. Megjithatë, kriteret minimale për përpilimin e silabusit janë: emërtimi i lëndës, kreditë (ECTS),

qëllimet e lëndës, rezultatet e pritura, paraqitja e përjavshme e përmbajtjes së lëndës apo temave të ligjëratave dhe ushtrimeve, literatura, kriteret e vlerësimit periodik (dhe përfundimtar) dhe notimit.

Silabusi është letërnjoftimi i lëndës përkatëse. Asnjë lëndë e dhënë në Departamentin e Antropologjisë nuk mund të realizohet pa silabusin e përpiluar paraprakisht nga bartësi

i lëndës. Secili studentë që ndjek lëndën duhet të ketë qasje në silabusin e lëndës. Silabuset vendosen në SEMS, mund të dërgohen në formë elektronike, vendosen në ueb faqe të Departamentit, në kuadër të

ueb faqes së Fakultetit, apo edhe në faqet personale të bartësve të lëndës, brenda ueb faqes së Fakultetit.

Bartësit e lëndës obligohen t'i përmbahen silabusit.

A ka literaturë të mjaftueshme?

Literatura antropologjike në gjuhën shqipe, si në antropologji kulturore si në arkeologji, është e kufizuar. Studimet etnologjike dhe arkeologjike shqiptare kanë nisur të zhvillohen brenda katedrës arsimore institucionale pas Luftës së Dytë Botërore. Po ashtu, grupi i studiuesve bashkëkohorë në fushën e antropologjisë nuk është i madh. Prandaj, edhe veprimtaria botuese është e kufizuar.

Në anën tjetër, literatura antropologjike në gjuhët e huaja, sidomos në gjuhën angleze, është tejet e pasur në të gjitha disiplinat, nëndisiplinat e temat specifike. Ekzistojnë disa përkthime të veprave antropologjike në gjuhën shqipe, por ato janë të pakta në numër. Prandaj, studentët e antropologjisë inkurajohen të lexojnë literaturën në gjuhën angleze, frënge, gjermane, italiane, e në gjuhët tjera, sipas mundësisë së tyre. Po ashtu, gjuha e huaj është esenciale në studimet antropologjike.

Secila lëndë ka silabusin apo plan-programin e saj ku jepet literaturë kyçe dhe literaturë shtesë. Literatura mund të gjendet në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani", në bibliotekën e Fakultetit Filozofik, në Bibliotekën e Prishtinës "Hivzi Sylejmani",

por edhe në biblioteka të tjera. Nuk është e obligueshme, por studentët mund të huazojnë literaturë edhe nga profesorët e tyre.

Shkrimet sporadike në internet duhet të mënjahen, sepse mund të jenë orientime të pakontrolluara dhe shkurtesa hutuese.



A ka bibliotekë Departamenti i Antropologjisë?

Departamenti i Antropologjisë ka sektorin e tij, përkatësisht raftet e tij të veçanta, në kuadër të bibliotekës së Fakultetit Filozofik. Kjo bibliotekë është e vendosur në katin e 3-të të godinës së fakultetit. Studentët mund të kenë qasje të lirshme në librat e saj, t'i huazojnë për lexim. Shumica e librave që përfshihen në silabuset e secilës lëndë, janë pjesë e kësaj biblioteke e cila pasurohet në vazhdimësi me botime të reja.

Studentët inkurajohen të huazojnë në vazhdimësi libra nga biblioteka e

fakultetit dhe të lexojnë sa më shumë e të familjarizohen me tekstin, duke kultivuar kulturën e tyre të leximit.

Siç u theksua edhe më lart, studentët mund t'i shfrytëzojnë bibliotekat tjera të qytetit, ato rajonale, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Bibliotekën e Arkivit të Kosovës, Bibliotekën e Institutit Albanologjik të Prishtinës, Bibliotekën e Institutit Arkeologjik, Bibliotekën e Muzeut Kombëtar të Kosovës, Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës etj.



Disa këshilla për lëndët obligative dhe zgjedhore

Në tabelën e strukturës së programit, të dhënë më lart, identifikohen lëndët obligative dhe ato zgjedhore. Studentët mund të zgjedhin lëndë të ndryshme zgjedhore sipas dëshirës dhe interesimit të tyre. Lëndët zgjedhore mund të realizohen nëse studentët krijojnë grup klasor në përputhje me normat në fuqi të Universitetit të Prishtinës.

Studentët mund të marrin lëndë zgjedhore edhe në kuadër të programeve BA të departamenteve tjera të Fakultetit Filozofik, por edhe të Universitetit. Po ashtu, studentët mund të bëjnë edhe “studime individuale” ku përzgjedhin lëndë të ndryshme nga njësitë akademike, gjithnjë me aprovimin e Këshilli të Fakultetit. Për më shumë shih nenin 98 të Statutit të UP-së.

Cilat janë format e komunikimit mes stafit akademik dhe studentëve?

Studentët mund të komunikojnë me profesorët, asistentët në të paktën tri mënyra: drejtpërdrejtë gjatë ligjëratave, ushtrimeve; në zyrat e tyre gjatë orareve të konsultimeve, orare këto të cilat janë publike në dyert e zyrave të secilit profesor; si dhe përmes emailëve zyrtarë, ku secili profesor ka një e-mail sipas një formati standard të Universitetit të Prishtinës që ndjek

këtë rregull: emri.mbiemri@uni-pr.edu. Përtej kësaj, për të komunikuar ankesat e tyre eventuale, paqartësitë, kërkesat, studentët mund të komunikojnë nëpërmjet të njëjtave rrugë me udhëheqësin, sekretarin e departamentit. Këta të fundit, në varësi të rasteve mund të shërbejnë si urë komunikimi me dekanatin apo rektoratin e universitetit.

Si organizohet viti akademik dhe kur janë afatet e provimit?

Programi zgjat tre vite dhe ka gjashtë semestra. Secili vit ka dy semestra, atë dimëror, i cili fillon me 1 tetor dhe zgjat deri me 15 janar. Semestri veror fillon me 15 shkurt dhe përfundon me 31 maj. Ligjëratat nuk mbahen nga periudha 15 janar deri me 15 shkurt. Mësim nuk ka gjatë ditëve të pushimit në përputhje me kalendarin zyrtar të

ditëve të pushimit të Republikës së Kosovës, respektivisht Universitetit të Prishtinës.

Gjatë vitit akademik organizohen tre afate të provimeve janar apo shkurt, qershor dhe shtator. Orari zyrtar shpallet në ueb faqen, buletinën e Fakultetit Filozofik. Për të fituar të

drejtën e hyrjes në provim, studentët duhet të kenë të regjistruar semestrin paraprak, duhet të bëjnë paraqitjen e provimit/eve në SEMS. Numri i provimeve që mund t'i nënshtrohen gjatë këtyre afateve nuk është i kufizuar.

Studentët nuk mund të paraqesin provim:

- pa i ndjekur ligjëratat e semestrave paraprak,

- pa i përfunduar provimet e vitit paraprak (shembull: studenti pa i përfunduar provimet e vitit të parë nuk mund t'i nënshtrohen provimeve të vitit të dytë),
- nëse studenti/ja bie ndesh me kodin disiplinor të Fakultetit Filozofik dhe ndaj tij/asaj është shqiptuar masa e ndalesës nga Komisioni Disiplinor.

Si vlerësohen dhe notohen studentët?

Studentët vlerësohen në vazhdimësi gjatë gjithë semestrit. Ky quhet vlerësim periodik. Vlerësimi do të mbështetet në këto shtylla: pjesëmarrja, interaktiviteti, hulumtimi, rezultatet e testeve periodike. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë të specifikuara me silabus/planprogram sipas secilës lëndë në përputhje me specifikat e lëndës. Profesorët obligohen që në orën e parë të semestrit të prezantojnë dhe shpërndajnë silabusin e lëndës duke shpjeguar, në mes tjerash, procedurat e vlerësimit.

Në rast se studenti/studentja nuk ka arritur rezultat pozitiv në lëndë të caktuar apo nuk pranon notën e marrë, ai/ajo ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim kundër notës së marrë. Ankesa bëhet te dekani i Fakultetit dhe pas pranimi me kohë të ankesës, dekani formon komisionin e vlerësimit për rivlerësim. Procedurat e parashtrimit të ankesës për notën e marrë apo rezultatin e provimit jepen në nenin 114 të Statutit të UP-së.

Periudha e notimit nënkupton dhënien e notës përfundimtare brenda afatit të provimit pas përfundimit të obligimeve të lëndës nga ana e studentit, si në rastin e testeve periodike ashtu edhe në provimin përfundimtar. Secili student ka 72 orë kohë të ankohet, të kërkojë arsye shtesë, të konsultohet apo të refuzojë notën, që i vendoset në konton e tij në formë elektronike, sistem i quajtur SEMS. Gjatë kësaj kohe, për arsye specifike, të cilat profesori duhet t'i bëjë të njohura për studentin, mund të ndërrohet edhe notimi. Pas periudhës 72 orëshe, SEMS-i mbyllet dhe nota nuk mund të ndërrohet. Notat e përfunduara të atij afati, shtypen dhe arkivohen në Fakultet si të tilla në administratë.

Profesorët e Departamentit të Antropologjisë i përfillin procedurat e vlerësimit dhe notimit të dhëna shprehimisht në Statutin e UP-së. Po ashtu, edhe kriteret dhe metodat e vlerësimit përfillin udhëzimet e procesit të Bolonjës, ku vlerësimi bëhet sipas "ECTS Grading Scale".

Vlerësimi ECTS Grading Scale

Kriteret specifike të vlerësimit jepen në çdo doracak të lëndës përkatëse. Notimi përputhet me vlerësimin. Kriter kryesor në llogaritjen e vlerësimit dhe notimit do të merret 'ECTS Grading Scale' (shih tabelën) në parim me Kornizën Evropiane të Edukimit të Lartë.

GRADA ECTS	Përshkrimi	Barasvlera në sistemin e UP-së	Përqindja
A	Shkëlqyeshëm – Përformancë e jashtëzakonshme me pak gabime të vogla	10	90 - 100%
B	Shumë mirë – mbi standardin e mesëm, por me disa gabime	9	80 - 89%
C	Mirë – në përgjithësi punë e mirë, por me disa gabime të konsiderueshme	8	70 - 79%
D	E kënaqshme – Mirë por me ngecje të konsiderueshme	7	60 - 69%
E	Kaluese – përmbush vetëm kriteret minimale	6	50 - 59%
F	Jokaluese – kërkohet përsëritje e punës për të marrë kreditet	5	Nën 50%

Kjo shkallë e vlerësimit/notimit korrespondon edhe me përcaktimin e suksesit akademik të rregulluar me Statutin e UP-së, nenin 109.

Vlerësimi dhe notimi i studentëve bëhet sipas procedurave, orarit dhe kriterëve të caktuar në silabus të lëndës. Vlerësimi bëhet duke kombinuar vlerësimin në mënyrë periodike dhe me provim përfundimtar.

Cila është procedura e diplomimit?

Secili student që synon të përfundojë studimet themelore (Bachelor) në Departamentin e Antropologjisë duhet të kalojë nëpër procedurën e diplomimit. Kjo procedurë nënkupton dhënien e provimeve në të gjitha lëndët e programit përkatës (të akredituar) të cilat janë të kredituara me ECTS dhe arritjen e shumës së 180 krediteve, të kërkuara, për të marrë diplomën përkatëse.

Po ashtu, ekziston edhe tema e diplomës si lëndë e veçantë, që quhet “punimi i diplomës” dhe ka 7 kredite. Studenti mund ta zgjedh profesorin përkatës për të mbikëqyrur punimin e temës së diplomës. Preferohet që të përzgjidhet profesori që është më i specializuar me temën e përzgjedhur të studentit. Mbikëqyrja e temave bëhet sipas përzgjedhjes së studentit, por në rast kur një profesor ka tema më shumë se sa që është e mundshme t’i mbikëqyrë, ka të drejtë të refuzojë të marrë përsipër të mbikëqyrë tema tjera derisa të lirohet. Po ashtu, në rast të diskrepancës së madhe në mbikëqyrjen e temave, udhëheqësi i departamentit sygjeron mbikëqyrjen e temës përkatëse të profesori tjetër.

Lënda “Punimi i diplomës” mbahet në semestrin VI, semestri i fundit i studimeve Bachelor, që zgjat deri në fund të gushtit. Preferohet që studentët të përzgjedhin profesorin dhe të propozojnë temën e tyre në fillim të semestrit në mënyrë që të kenë kohë për

konsultime, ndryshime, dialog akademik me profesorin.

Secili student mund të ketë deri në 6 orë konsultime, një me një, me profesorin përkatës, gjatë semestrit përkatës. Studentët mund të konsultohen edhe me profesorët tjerë me rekomandim të profesorit mbikqyrës apo sipas nevojës dhe mundësisë së tyre dhe profesorit përkatës.

Plotësimi i kërkesës për mbrojtjen e punimit të diplomës bëhet me referenten e Departamentit. Referentja e pajis studentin me një certifikatë duke dëshmuar kështu se i njëjti i ka të përfunduara të gjitha provimet e parapara me programin e studimeve dhe i plotëson të gjitha dispozitat administrative për të proceduar mbrojtjen e punimit të diplomës.

Mbrojtja e diplomës bëhet para një komisioni prej tre profesorëve duke përfshirë edhe mentorin e kandidatit. Mbrojtja mund të jetë e hapur ose e mbyllur, varësisht nga kërkesa e kandidatit dhe dakordimi paraprak i komisionit me studentin.

Në rast të pakënaqësisë apo mosmarrëveshjes, studenti mund të konsultohet me udhëheqësin e Departamentit për të zgjidhur mosmarrëveshjet relevante. Në rast të mosmarrëveshjes dhe pamundësisë për bashkëpunim, pas shqyrtimit nga Departamenti, studenti mund të kërkojë ndërrimin e mbikëqyrësit të temës së tij.

Si mund të ankohen studentët dhe ku?

Gjatë studimeve studentët mund të kenë ankesa të natyrave të ndryshme. Në këto raste, nëse është fjala për gjëra të vogla, studentët mund të provojnë t'i zgjidhin së pari drejtpërdrejtë me profesorët apo studentët, kurse nëse është fjala për ankesa të natyrave tjera, si fyerja,

ngacmimi, aktet e dhunës, ankesa për logjistikën, infrastrukturën, ata mund t'i drejtohen udhëheqësit ose sekretarit të departamentit ose direkt dekanatit. Varësisht nga rasti, ankesat dhe kërkesat mund të bëhen drejtpërdrejt ose me shkrim.

Si fitohet kushti për studim në vitin vijues?

Kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore BA bëhen sipas vendimit të Senatit. Shih vendimin e fundit të Senatit me nr. Protokoli 2/862, të datës: 10 Tetor 2017, ku jepen kushtet për regjistrimin e secilit

në vitin akademik. Vendimi gjendet në ueb faqen e Universitetit, në rubrikën: "Vendime dhe rregullore". Për më shumë shih: <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,35>

Sa angazhohen studentët në punë praktike?

Fjala "punë praktike" ka kuptim të gjerë. Ajo mund të kuptohet edhe si punë praktike brenda programit pedagogjik, por edhe jashtë tij, apo në raport me të. Në Departamentin e Antropologjisë, studentët bëjnë punë praktike në shumicën e lëndëve, përfshirë edhe lëndët me fokus në histori të ideve e traditës së disiplinave antropologjike. Po ashtu, Departamenti ka një marrëveshje (memorandum mirëkuptimi) me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për t'u ofruar mundësi për punë praktike të gjithë studentëve së paku një herë gjatë studimeve. Por, studentët bëjnë punë praktike edhe në kuadër të projekteve e aktivitete tjera hulumtuese, që organizohen në kuadër të Departamentit.

Në vitet e fundit mbi 100 studentë të arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore kanë realizuar punë praktike për 3 muaj në institucionet vartëse të Ministrisë së Kulturës: Muzeun e Kosovës dhe muzetë rajonale, Arkivin e Kosovës, Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Institutin për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Monumenteve të Kulturës, në projektin frako-shqiptarë në Ulpianë, në projektet e Institutit Arkeologjik të Kosovës, disa edhe në projektin eurvejimit në komunën e Pejës nga Universiteti i Michiganit, SHBA, Institutin për Studime Sociale dhe në Fakultetin Filozofik, si dhe në programin universitar për studime dhe hulumtime gjinore (UPGSR) në Universitetin e Prishtinës.

Në kuadër të projekteve ekzistuese në Departamentin e Antropologjisë studentët kanë mundësi të kryejnë punë praktike siç janë: realizimi i intervistave, realizimi i anketave, gërmimet arkeologjike, punë muzeale (inventarizim, konservim, restaurim, punë kuratoriale, fotografim, video inçizim etj), organizim i tryezave, punëtorive, punë arkivore në departament (Arkivi

për fotografi dhe video, Programi i Etnografisë Vizuele).

Po ashtu, Departamenti i Antropologjisë shqyrton në vazhdimësi edhe marrëveshje të reja me institucione tjera për t'iu mundësuar studentëve punë praktike, intership dhe pjesëmarrje në projekte të ndryshme.

A ka programe shkëmbimi për studentët?

Disa nga mundësitë kryesore të realizimit praktik të aftësive të marra gjatë studimeve janë edhe projektet e përbashkëta të hulumtimit dhe shkëmbimit.

Në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese me institucione ndërkombëtare, Departamenti i Antropologjisë ka nënshkruar katër marrëveshje për mobilitet të studentëve dhe stafit. Katë r janë në kornizën Erasmus+: një në Arkeologji me Universitetin Lumière Lyon 2, në Lion, Francë; e dyta në Etnologji dhe Antropologji Kulturore me Departamentin e Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore të Universitetit të Zagrebit, e treta me Bournemouth University, në Mbretërinë e Bashkuar, Fakulteti i Shëndetit dhe Shkencave Shoqërore, i cili gjithashtu përfshinë punë praktike për studentë. E katërta është me Universitetin e Lubjanës në Slloveni.

Marrëveshja e katërt është mes Universitetit të Prishtinës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ecole

Normale Supérieure dhe Ambasadës Franceze në Prishtinë.

Në mënyrë specifike, ky bashkëpunim ka për qëllim krijimin e një shkolle verore ndërkombëtare arkeologjike. Është paraparë që studentët të marrin pjesë në gërmime arkeologjike, të bëra nga Ecole Normale Supérieure. Përmes këtij bashkëpunimi mentorimi i studentëve të masterit dhe doktoratës do të bëhet bashkë. Për më tepër, Ambasada e Francës do të mbështesë me bursa dy studentë për çdo vit për të vazhduar studimet e arkeologjisë në Francë.

Po ashtu, studentët dhe stafi kanë mundësi të marrin pjesë në programe hulumtuese, shkëmbimi, me institucione edukative, arsimore, me të cilat Departamenti dhe Universiteti kanë marrëveshje bashkëpunimi. Studentë të Departamentit kanë kryer një semester në universitete të ndryshme si në Çeki, Hungari, Angli, Francë, etj.

Çfarë projektesh hulumtuese, trajnuese dhe praktike ekzistojnë brenda Departamentit?

Në vitet e fundit, mësimdhënësit e Departamentit të Antropologjisë kanë nisur një sërë projektesh hulumtuese. Në këto projekte hulumtuese, të cilat vazhdojnë gjatë tërë vitit aka-

demik, marrin pjesë ligjëruesit dhe studentët. Aktualisht, Departamenti i Antropologjisë është duke realizuar këto projekte hulumtuese:



Projekti i hulumtimit arkeologjik në bashkëpunim me Ecole Normal Supérieure

Që nga vitit 2016, dy profesorë dhe dhjetëra studentë të Departamentit të Antropologjisë, kanë qenë pjesë e projektit të hulumtimeve dhe studimeve interdisciplinare (me fokus kryesor në arkeologji) që realizohen

në lokalitetin e Ulpianës në kuadër të projektit të përbashkët që realizohet nga Departamenti i Antropologjisë, Ecole Normale Supérieure dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës. Projekti pritet të vazhdojë edhe për disa vite.

Projekti i historisë gojore “Kujtesa e Kosovës, rrëfime nga 100 pleq e plaka” 2017- 2019

Që nga viti 2017, 2 profesorë dhe 15 studentë të Departamentit të Antropologjisë kanë realizuar 100 intervista të gjata autobiografike me pleq e plaka mbi 80 vjeç, në gjithë territorin e Kosovës, për të regjistruar kujtesën e tyre personale si histori gojore për hulumtime të mëtutjeshme. Rrëfimet e tyre autobiografike janë botuar në formë libri të shtypur dhe elektronik (2019) dhe janë të hapura për publikun e gjerë që t'i dëgjojë, studiojë dhe t'i përdor për qëllime hulumtuese, edukative e kreative.

Ky projekt i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës u realizua në bashkëpunim me Departamentin e Antropologjisë dhe u financua nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës. Projekti do të vazhdojë me tema tjera specifike në vitet e ardhshme, ku studentët mund të inkurajohen të marrin pjesë.

Projekte të tilla mbi kujtesën e Kosovës priten të vazhdojnë në vitin 2021.



Hulumtime dhe gërmime arkeologjike në lokalitete të ndryshme

Që nga viti 2014, disa profesorë nga Departamenti kanë realizuar hulumtime dhe gërmime arkeologjike në një sërë lokalitetesh arkeologjike (Ulpianë, Harilaq, Korishë, Cërnica, Vuçak etj.) nga periudhat e ndryshme historike në Kosovë, në kuadër të bashkëpunimit me Institutin Arkeologjik të Kosovës. Pjesë e këtyre projekteve kanë qenë një numër i studentëve

(mbi 50 studentë) të Departamentit, duke punuar në grup me studentë të tjerë të Universitetit të Prishtinës, universiteteve nga Franca, Shqipëria, Turqia, Gjermania, SHBA-ve etj. Studentët do të kenë mundësi që në vazhdimësi të jenë pjesë e këtyre projekteve.



Projekti “Ndryshimi i tregimit” 2018-2021

Prof. Nita Luci koordinon projektin katër vjeçar hulumtues dhe të aplikuar të quajtur “Ndryshimi i tregimit” (*Changing the Story*). Ky projekt hulumton praktikën e arsimit qytetar, të bazuar në arte, të institucioneve të pavaruara të artit dhe kulturës dhe institucionet formale të arsimit të mesëm dhe lartë në disa komuna të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë). Libri i parë me analiza të hulumtimeve të të gjithë partnerëve ka dalë nga shtypi gjatë vitit 2019. Gjithashtu projekti përkrah edhe projekti kërkimor mbi sistemin paralel të arsimit gjatë viteve të 1990 në

Kosovë i cili do të prodhojë përmbajtje programore për Muzeun “Shtëpia Shkollë”. Studentët e Departamentit të Antropologjisë janë të përfshirë në hulumtime (mbi 10 studentë), punëtori dhe aktivitete të tjera të projektit. Projekti udhëhiqet nga Universiteti i Lidsit (University of Leeds), i përkrahur nga GCRF (Global Challenges Research Fund) i Këshillit për Arte dhe Humanistikë i Mbretërisë së Bashkuar (UK Arts and Humanities Research Council), dhe përfshinë universitete dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare në katër kontinente.



Shkolla Arkeologjike

Shkolla arkeologjike në Ulpianë është themeluar si rezultat i bashkëpunimit të Departamentit të Antropologjisë me Institutin Arkeologjik të Kosovës dhe Ecole Normale Supérieure (Francë). Shkolla organizohet çdo vit në muajin korrik dhe mbledh profesorë, studentë vendor dhe ndërkombëtar. Studentët në shkollën arkeologjike në Ulpianë kanë mundësi të mësojnë, praktikojnë metodat bashkëkohore që aplikohen në fushën e hulumtimeve arkeologjike.

Programi i kushton një rëndësi të veçantë qasjes multidiciplinare, duke iu ofruar studentëve gjithashtu njohuri edhe nga disiplinat arkeologjike si: arkeometalurgjia, arkeobotanika, analizat kimike etj. Pas përfundimit të programit i cili zgjatë dy deri në tri javë, studentët pajisen me certifikata. Kreditet e fituara, studentët mund t'i zbatojnë në kuadër të lëndëve mësimore, silabuset e të cilave e parashohin punën praktike në terren.



Programi per Etnografi Vizuele

Ky program është themeluar më 2017, në kuadër të Insitutit për Studime Sociale dhe Humanistike. Ndër aktivitetet kryesore të PEV-it kanë qenë mbledhja dhe digjitalizimi i mbi 2000 fotografive familjare nga studentët e antropologjisë kulturore në tërë Kosovën. PEV ka organizuar edhe ekspozitën me 150 fotografi të kornizuara që kanë treguar përditshmërinë e jetesës në Kosovë, të cilat janë ekspozuar në 5 komuna të Kosovës. Po ashtu, PEV-i ka shfaqur mbi 20 filma etnografikë dhe ka zhvilluar diskutime me studentë dhe të interesuar gjatë sesioneve të ndryshme. Në kuadër të aktiviteteve të saj PEV ka mbaj-

tur edhe punëtori 3 ditore mbi filmin etnografik nga profesorsha Kelly Askev (Universiteti i Michingan Ann Arbor). Po ashtu, ka prodhuar edhe “Doracakun e hulumtimit vizuel” (12 dokumente). Në vitet e fundit PEV ka organizuar edhe ligjërata me profesorë vizitorë për trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë e qasjes vizuele në studimet antropologjike.



Seminari i Antropologjisë

Seminari organizohet si seminar periodik, ku secilën të enjte të fundit të muajit (8 muaj të vitit akademik), mbahen ligjërata me temë specifike nga studiues të ndryshëm nga universite vendore, rajonale dhe botërore. Seminari është themeluar në vitin 2018. Seminari organizon edhe punëtori

praktike, tryeza diskutimi, intervista me të ftuar të ndryshëm. Përmes Seminarit synohet të kultivohet dialogu antropologjik mbi kulturën, traditën, shoqërinë, shtetin, ndryshimet shoqërore. Aktivitetet e Seminarit mund të shihen në uebfaqen e Departamentit të Antropologjisë.



Çfarë përkrahje tjetër profesionale ekziston për studentët?

Universiteti i Prishtinës ka një numër të qendrave dhe zyrave të cilat ofrojnë përkrahje profesionale: shkëmbime akademike, trajnime, udhëzime që kontribuojnë në ngritjen e tyre akademike dhe profesionale. Ndër to: Qendra për Zhvillim të Karrierës: <https://ekarriera.uni-pr.edu/login/>

Zyra për Marrëdhënie me Jashtë: <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,7>
VentureUP: <http://venture-up.org/>
Universiteti Veror i Universitetit të Prishtinës: <https://uvp.uni-pr.edu/>
Shkolla Verore për Studime Gjinore: <https://genderstudies.uni-pr.edu/>

Si përfaqësohen studentët në nivel universiteti?

Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” e parasheh përfaqësimin studentor në nivel të këshilleve të studentëve në kuadër të njësive akademike. Parlamenti i Studentëve është i përbërë nga për-

faqësues të zgjedhur nga përbërja e këshillave të studentëve. Për procesin e përfaqësimit dhe zgjedhjeve mund t'i referohen Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Sa kanë të gjithë studentët mundësi të barabarta?

Departamenti i Antropologjisë i respekton kriteret dhe udhëzimet e dala nga rregulloret e Universitetit të Prishtinës për mundësi të barabarta për të gjithë dhe mbrojtje nga diskriminimi në baza politike, racore, ngjyrës, fesë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike, origjinës kombëtare, prejardhjes, statusit martesor, shtatzënisë, aftësitë e kufizuara dhe synon të ofrojë një ambient të afërt edukativ, profesional dhe intelektual për të gjithë pa dallim.

Mundësitë e barabarta vlejnë në pranimin në studime, ndonëse UP ka disa vende të rezervuara për kategoritë e caktuara të studentëve si dhe diasporës. Senati i UP-së nxjerr rregullore të cilat përcaktojnë në hollësi kriteret dhe kushtet për regjistrim në studimet themelore (Bachelor), të cilat u paraprijnë konkurseve të shpallura të UP-së për regjistrim. Për më shumë shih Statutin e UP-së, nenin 103 dhe 106.

Si monitorohen dhe vlerësohen mësimdhënësit?

Monitorimi dhe vlerësimi i procesit mësimor realizohet gjatë gjithë vitit akademik nga Departamenti dhe menaxhmenti i Fakultetit Filozofik, Parlamenti Studentor dhe menaxhmenti i Universitetit. Sipas politikave për sigurim të cilësisë gjithë studentët e kryejnë vlerësimin e lëndëve

dhe mësimdhënësve duke plotësuar formularët e vlerësimit në SEMS.

Edhe bartësit e lëndës mund të bëjnë monitorime dhe vlerësime të tyre të pavarura për arsye të zhvillimit të lëndës, silabusit dhe qasjes së tyre pedagogjike.

Cilat janë mundësitë e punësimit të studentëve të diplomuar në Departamentin e Antropologjisë?

Nga përvoja e të diplomuarëve në Departamentin e Antropologjisë, institucionet më poshtë ofrojnë mundësi potenciale për punësim:

- Institucionet e arsimit të ulët, të mesëm dhe të lartë në Kosovë dhe më gjerë;
- Instituti i Historisë, Prishtinë;
- Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë;
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë;
- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, Prishtinë;
- Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë;
- Muzetë Regjionale dhe Komunale;
- Qendrat Regjionale të Trashëgimisë Kulturore nëpër Kosovë;
- Drejtoritë Komunale për Kulturë dhe Rini;
- Organizatat jofitimprurëse (kombëtare dhe ndërkombëtare) nëpër Kosovë;

- Arkivat (kombëtare, regjionale dhe lokale);
- Bibliotekat publike, nëpër Kosovë;
- Mediat vizuale, shkruara, online;
- Shoqatat kulturore dhe profesionale, nëpër Kosovë dhe më gjerë;
- Agjencitë turistike;
- Si guidë turistike
- Bizneset e ndryshme të turizmit dhe rekreacionit.

Pra, gama e vendeve të punësimit është e madhe, në nivel lokal dhe qendror, duke përfshirë agjencitë dhe organizatat që promovojnë turizmin, zhvillimin rural, organizatat humanitare - ato për gjithpërfshirje shoqërore, ambientaliste, të shëndetit publik dhe komunitetet e ndieshme. Një numër i madh i studentëve kanë marrë edhe iniciativa personale për të hapur biznese në fushën e industrisë kreative.

Cilat janë masat e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit?

Fakulteti Filozofik ka rregulluar, sipas mundësive që disponon, infrastrukturën e nevojshme të sigurisë. Brenda fakultetit janë shkallët dalëse për raste emergjente, kutitë e alarmit të vendosura nga institucionet e zjarrfikësve dhe bombolat e gazit për shuarjen e zjarrit, të cilat janë të vendosura në korridore të godinës së fakultetit dhe nëpër salla. Fakulteti Filozofik, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, ka të kontraktuar një kompani të sigurisë e cila merret me sigurinë fizike brenda hapësirave të fakultetit. Gjithashtu, të gjitha hapësirat e përbashkëta të fakultetit vëzhgohen 24 orë me kamera.

Gjatë kohës së studimeve, studentët përdorin infrastrukturën e fakultetit (bankat, karriket, tabelat, dyert, dritaret, kompjuterët në shërbim të studentëve etj), hapësirat për punë praktike, laboratorët (Programmi i Etnografisë Vizuele, Arkivi për Video dhe Fotografi, Programi për Studime dhe Hulumtime Gjinore, Salla e Arkeologjisë – në të cilën gjendet një koleksion modest me artefakte arkeologjike). Pas përfundimit të aktiviteteve të tyre në hapësirat e fakultetit, studentët duhet t'i mbyllin dritaret dhe dyert, kështu e evitojnë vjedhjen e këtyre aseteve të çmuara, dëmtimin e tyre nga lagështia dhe gazrat e ndryshme të dëmshme.

Meqënëse, Universiteti i Prishtinës nuk ka dikaster që mbulon aspektet e sigurimit shëndetësor, çështja e sigurimit shëndetësor të studentëve është përgjegjësi individuale e çdo

studenti. Me rastin e organizimit të ekspeditave hulumtuese jashtë ambienteve universitare, studentët do të këshillohen nga profesorët për masat parandaluese kundër ekspozimit ndaj rreziqeve të mundshme.

Në rastet kur studentët angazhohen në terren, në ekspedita hulumtuese antropologjike dhe arkeologjike, bartësit e projekteve duhet t'a informojnë me kohë studentin pjesëmarrës për rreziqet me të cilat mund të përballen. Por edhe në këto raste, Departamenti nuk ka sigurim kolektiv, andaj përgjegjësia bie mbi vetë studentin.

Gjatë kohës së studimeve studentët mund të udhëtojnë jashtë shtetit për ekspedita hulumtuese, të përfshihen në programe ndërkombëtare të shkëmbimit të studentëve, me ç'rast mund të kalojnë një semestër në ndonjë universitet ndërkombëtar. Meqënëse, në udhëtimet jashtë shtetit sigurimet shëndetësore janë obligative, i informojmë studentët që sigurimin shëndetësor mund ta bëjnë në kompani të cilat ofrojnë shërbime të tilla apo sipas rregulloreve të institucionit bartës ndërkombëtar mbi sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen.

Kodi i Etikës dhe aktet tjera normative në fuqi të Universitetit të Prishtinës, specifikojnë udhëzime për mbrojtje nga diskriminimi, ngacmimi dhe ngacmimi seksual, përcaktojnë masat për ofrim të ambientit të sigurtë për personelin akademik dhe administrativ dhe studentët.

Si qëndron bashkëpunimi mes studentëve të diplomuar dhe Departamentit?

Në vitin 2018 në kuadër të Universitetin të Prishtinës është krijuar Shoqata Alumni e UP-së. Studentët e Departamentit të Antropologjisë pas studimeve mund të bëhen pjesë e

këtij Asociacioni Alumni UP Hasan Prishtina, dhe mund të regjistrohen këtu: <https://ekarriera.uni-pr.edu/register/>

Mendimet e disa studentëve për Departamentin e Antropologjisë

Artan Ademaj (2017 - 2020)



Unë jam Artan Ademaj dhe jam nga qyteti i Pejës. Unë studioj antropologjinë kulturore në Departamentin e Antropologjisë. Si fëmijë gjithmonë kam qenë i interesuar për temat që lidhen me antropologjinë. Më pëlqente të dija më shumë rreth historisë, kulturave të ndryshme, sjelljes njerëzore dhe kjo është arsyeja pse zgjodha të studioj antropologjinë kulturore në studime universitare. Si qytetar i Kosovës mund të them se nuk kemi aq shumë mundësi për të studiuar jashtë vendit. Kur e pashë shpalljen e programit Erasmus+ që i dedikohej

pikërisht lëmisë të cilën e studioj, u gëzova shumë. Së pari isha i emocionuar se mund të studioja vërtet në Universitetin e Bournemouth-it në Mbretërinë e Bashkuar, por edhe për mundësinë në përgjithësi. Aplikova dhe u pranua në program dhe fillova studimet në Angli në fund të shtatorit të vitit 2019-të për një semester. Në Universitetin e Bournemouth-it kam ndjekur lëndë nga programi i antropologjisë dhe sociologjisë. Gjithmonë kam dashur të shoh se si është sistemi arsimor dhe përvoja në vende të tjera. Në Universitetin e Bournemouth-it do të dëshiroja të shkoja përsëri, por pse jo edhe në Universitete të tjera kudo në botë.

Gjatë gjithë periudhës së semestrit tim të shkëmbimit ERASMUS + kam kaluar rreth 1.5 orë në ditë të paktën duke lexuar e mësuar rreth lëndëve që I mbanim atje. Ajo që më emociononte më shumë ishin ligjëratat, secila prej tyre ishte kaq interesante dhe absolutisht e mahnitshme. Gjithashtu, takimi me njerëz të rinj dhe zbulimi i kulturave të reja ishte një mundësi më shumë. Në fillim ndihesha mirë që isha larg shtëpisë,

sepse ndihesha sikur jetoja një stil të ri të jetës, në një farë mënyre, por sidomos gjatë pushimeve ndjeva nostalgji dhe mall, sepse shihja njerëz me familjet e tyre nëpër rrugë. Por që e lehtë edhe për mua sepse komunikoj me familjen dhe miqtë e mi në vendin tim, kisha së paku një orë në ditë për të biseduar me ta.

Në të vërtetë studimi jashtë vendit është i rëndësishëm për degën që e studioj, sepse u njoha me një kulturë krejt të re dhe këto janë tema që antropologjia i studjon. Për më tepër, do thoja që më pëlqeu ambienti i Universitetit shumë, pasi kishte shumë biblioteka, plot ambiente pune dhe pajisje të nevojshme për studentë. Gjëja më e rëndësishme që kam mësuar nga kjo përvojë ishte se unë gjithmonë duhet të jem me mendje të hapur dhe gjithmonë t'u them po sfidave të reja, sepse kështu do të mësoj më shumë gjëra, si në jetën personale, po ashtu dhe në karrierë. Mendoj se perspektiva ime ka ndryshuar në shumë mënyra që nga të jetuarit jashtë vendit, kam zbuluar kulturë të reja, mënyra të reja të jetesës, njerëz të rinj nga kombe e preardhje e kultura të ndryshme.

Kjo përvojë ka pasur shumë ndikim në planet e mia për të ardhmen, sepse tashmë ndihem i gatshëm të punoj në ambiente të ndryshme, me njerëz të kulturave rreth e përqark botës. Do të thoja se qëndrimi im jashtë vendit ka rritur perspektivat e mia për të ardhmen dhe pjesëmarrja ime ka kontribuar pozitivisht në ndërgjegjësimin tim global dhe zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Do tua rekomandoja patjetër këtë program studenteve tjerë.

Besjana Rrahmani (2017 - 2020)

Vendi huej mu bá shpi

Nuk ka pasur asgjë më esenciale e transformuese për mua se njoftimi dhe përballja me dimensionet e panjohura të fytyrave të jashtme të antropologjisë. Përvoja ime si studente e programit të shkëmbimit ERASMUS + ka qenë e tillë.

Përshtypjet e mia të para ndaj vetë institucionit të Universitetit të Ljubjanës mund të them se i kanë përmeshur me përpikëri pritshmëritë e mia personale. Jam ndjerë me të vërtetë e afërt me njerëzit atje dhe shpeshherë ende më merr malli për rutinën e Ljubjanës. Mund të them se sjellja e tyre që nga bibliotekistja e Departamentit, e deri tek koordinatori i të gjithë studentëve të ERASMUS +, ka qenë aq mikëpritëse, sa që asnjëherë nuk e kam ndjerë ftohtësinë e të qenit e vetme në atë departament e ardhur nga areali kulturor ku po jetojmë sot.

Përvojat na formësojnë. Ndonjëherë krejt çfarë i nevojitet dikujt është një përvojë e re; një jetesë ku nuk përballesh me të njëjtat sfida çdo ditë, por vetëm sa i zgjeron dimensionin e tyre. Pata fatin që të takojë jo vetëm sllovenë, por edhe studentë të shteteve të tjera evropiane e aziatike. Në konvikt ka pasur mbi 150 studentë, që kanë ardhur me qëllime të njëjta si të miat: për të kaluar një semestër, ose dy, larg shtëpive dhe universiteteve të tyre dhe për të mësuar diçka të re.

Ka qenë sfidë për mua të adaptohem me sjelljet e secilit, por edhe kuriozitet. Tërë ato gatime të kuzhinave të ndryshme, që secili prej tyre ndante me ne. Të gjitha ato debate që


preknin fusha të ndryshme të studimeve tona. Diçka që me të vërtetë na bashkonte në çdo fund të ditës, ishin iniciativat e studentëve për t'u marrë me aktivitete artistike. Asnjëherë nuk mund të harrojë se si kemi gjetur kurajon për të formuar një grup teatror në qendrën studentore. Pasi që na ishte mohuar pjesëmarrja si grup në shfaqjet e Fakultetit të Arteve, ne vendosëm që të realizonim vetë shfaqjet tona. Ishim 5 veta dhe luanim veten duke treguar rrëfime për veten. Shpeshherë mendoj për gjithë ato rrëfime që kam pasur fatin t'i dëgjojë, dhe magjepsjen e tyre. Ato histori për vendin ku këta studentë janë rritur, më kanë pjekur shumë dhe në të gjitha aspektet.

Po e ndaj këtë përvojë me gjeneratat e ardhshme të studentëve të antropologjisë në Universitetin e Prishtinës, sepse shpresoj se studentët e ardhshëm të antropologjisë, do t'ia dalin që të krijojnë vetë përvojat e tyre.



Muze etnografik i Sllovenisë

Fatbardha Hoxha (2016-2019)



Studimi i arkeologjisë në këtë departament shërben si një hyrje në njohjen e botës së nëndheshme, historisë që e bartë ajo dhe gjithçka që ka mbetur mbi. Ne jemi homosapiens dhe arkeologjia do të na ndihmojë ta kuptojmë njëri-tjetrin më mirë. Për gjatë tre viteve kam mësuar për të gjitha fushat dhe periudhat e arkeologjisë ku mu krijua mundësia e formimit të identitetit tim arkeologjik dhe mundësia e gjetjes së vetes në një periudhë kohore historike gjë të cilën çdo student i arkeologjisë do ta gjejë. Gjatë kësaj kohe kam fituar përvoja të vlefshme në pjesë specifike të arkeologjisë duke punuar me njerëz që janë të kualifikuar në temat për të cilat më interesojnë. Departamenti me ka mundësuar të jem pjesë e shumë projekteve dhe gërmimeve nga organizues shqiptarë dhe të huaj që besoj se janë pjesa më e mirë e studimeve për ata që e duan terrenin, sepse në një mënyrë e mbështjellë komplet punën në sallë duke i dhënë arsye dhe kuptim. Kjo më ka ndihmuar në zhvillimin e shkathtësive si në njohjen e qeramikës,

lidhjen e kontekstit arkeologjik me atë historik, krijimin e rrëfimeve të tyre dhe ngritjen e vetëdijes për trashëgimi kulturore. Pas diplomimit në këtë program, kam vendosur të vazhdoj studimin edhe më tutje pasi për çdo “dua të bëhem arkeolog” tre vite janë kohë mjaft e shkurtër për tu formësuar në plotësisht. E këtë ma ka mundësuar Universiteti i Gjenevës, ku jam pranuar si studente e programit master në arkeologji para-historike. Secili që bëhet arkeolog i Kosovës, ka privilegjin të bëjë diçka për trashëgiminë arkeologjike këtu, diçka më shumë për perëndeshën dardane, për bretkosat e rëna nga qielli në Paioni dhe Dardani apo për Dandonin nga Iliria që sipas legendës jetoi 500 vjet.

Edijon Sellaj(2014-2018)



Ashtu sikur për shumë të rinj e të reja, edhe për mua, preokupimi i vetëm pas përfundimit të shkollimit të mesëm ishte se çfarë shtegu duhet do të ndiqja. Dëshira ime e kahmotshme për t'u njohur nga afër me historinë, kulturën, traditat, doket dhe zakonet e paraardhësve të njeriut modern, nuk mbetën vetëm dëshira fëmijërore sepse, për fatin tim të mirë, po atë vit u bëra pjesë e Universitetit të Prishtinës, pranë Departamentit të Antropologjisë (D. A.) respektivisht, programit të

Arkeologjisë. Njohuritë e fituara gjatë këtyre viteve të studimit, nëpërmjet diskutimeve interaktive me profesorë e kolegë në baza ditore, ndikuan drejtëpërdrejtë, jo vetëm në ngritjen e nivelit tim intelektual dhe profesional, por gjithashtu edhe në zhvillimin e mendimit tim kritik mbi temat që rrahin dijet humane. Në strumbullarin metodologjik të dijedhënies së ligjëruesve të D. A., përveç rrafshit teorik, ku kisha mundësinë të krijoja fillet e një ideje gjithë përfshirëse mbi zhvillimin e jetës së njeriut dhe mbi të gjitha kulturën e tij material ku bën pjesë edhe pjesa praktike. Këtë të fundit, falë shumë bashkëpunimeve që ka Antropologjia e kam realizuar në institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore në vend dhe jo vetëm. Pra, angazhimi në projekte të ndryshme arkeologjike të udhëhequra nga profesionistë vendorë dhe ndërkombëtarë, ishin ndër përvojat më mbresëlënëse që kam pasur si studente e antropologjisë. Rrjedhimisht, duke iu falënderuar profesorëve për kontributin e tyre të pashoq dhe mundësitë që u krijojnë studentëve, sot vazhdoj të ndjekë studimet e nivelit master në fushën e Arkeologjisë, në fakultetin e shkencave humane dhe shkencave sociale, pranë Pázmány Péter Catholic University, në Hungari. Për fund, do t'u bëja thirrje të rinjve që kanë dëshirë të zhyten e të eksplorojnë jo vetëm të kaluarën tonë njerëzore, por mbi të gjitha trashëgiminë e pasur lokale të Kosovës historike, të bëhen pjesë e Departamentit të Antropologjisë. Ky është shtegu që unë zgjodha, i cili padyshim, ofron parametrat e nevojshëm për të kuptuar nga kemi ardhur dhe, ndoshta, nga jemi duke shkuar.

Shtojca a)

Udhërrëfyes për shkrimin antropologjik

Në kuadër të programit studimor, studentët duhet të shkruajnë ese (punime seminarike). Eseja ka peshë të rëndësishme në vlerësimin dhe notimin e tyre sepse tregon pjekurinë e studentit në raport me leximet dhe punën e tij individuale.

1. **Relevanca:** Përmbajtja e esesë duhet t'i përgjigjet një pyetjeje hulumtuese. Kujdes me materiale që s'janë relevante me pyetjen apo objektin e shtjelluar. Studentët duhet të konsultohen me mësimdhënësit rreth temave potenciale dhe të marrin sugjerime nga ta.
2. **Hulumtimi i mirë:** Para se të shkruani një ese duhet të hulumtoni. Kjo nënkupton se duhet që së pari të lexoni. Zakonisht, një ese e mirë, në këtë nivel studimesh, duhet që së paku t'i ketë katër apo pesë referenca esenciale. Hulumtimet në terren (intervista, anketat, vërtetimet, matjet e ndryshme, fotografimet,urvejimet, gërmimet, etj) janë të mirëseardhura dhe kërkohen në shumicën e lëndëve, përveç në lëndët e vitit të parë. Evidenca nga terreni, si në arkeologji ashtu edhe në antropologji kulturore, është ajo që e shquan shkrimin antropologjik.
3. **Mendimi origjinal dhe shkrimi origjinal:** Njohja me literaturë përkatëse është esenciale, mirëpo nuk është e mjaftueshme. Eseja duhet të bazohet edhe në mendimin tuaj origjinal. Citatet ose parafrazimet duhet të jenë të gërshetuara brenda vazhdës së mendimit tuaj, për të evituar plagjiaturën. Pra, mendoni vetë dhe shkruani mendimet tuaja. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ju duhet të shpejtoni dhe të shkruani shkel e shko. Çdo mendim stimulohet nga një lexim i kujdesshëm dhe i gjerë.
4. **Organizimi:** Eseja juaj duhet të shkruhet drejtë duke prezentuar hapa logjikë, të qartë dhe konsistent në argumentimin tuaj, duke sjellur të dhëna relevante prej burimeve të ndryshme. Paragrafët janë: "bllloqet ndërtuese" të një eseje dhe çdo paragraf duhet të ketë ide, mendim apo shtjellim. Organizimi i mirë i argumentit në ese mund të arrihet vetëm me planifikim të mirë dhe me rilexim të herëpashershëm të shkrimit tuaj deri sa të arrini të shkrim final.

Pra:

- Filloni me një hyrje e cila e shfaq pyetjen hulumtuese apo temën e shkrimit.
- Tregoni se cilat janë metodat e përdorura në gjetjen e fakteve dhe arritjen e argumenteve në ese dhe qasjet kryesore teorike.
- Zhvillojeni diskutimin në mënyrë lineare dhe koherente. Në këtë rast para-

grafët dhe fjalitë duhet të rrjedhin logjikisht. Shtjellimi i esesë duhet të jetë në përputhshmëri me të dhënat nga terreni, qoftë nga intervista, qoftë nga vërtetimi i gjurmave, qoftë nga citatet e literaturës.

- Përfundimi i esesë suaj duhet të përmbledhë fjetet e argumentit dhe të prezentojë një variant të përgjigjes ndaj pyetjes fillestare (nistore) ose vlerësimin tuaj final. Mos harroni: s'ka përgjigje përfundimtare në antropologji, çdo përgjigje është një variant autorial i përgjigjes së autorit ndaj pyetjes së tij ose të tjerëve.
- Nëse ka mospajtim në literaturë rreth domethënies së disa termeve, atëherë përmendeni këtë dhe qartësoni se si do t'i përdorni termat e caktuara. Termat zakonisht definojnë atëherë kur përmenden. Mos u bazoni vetëm në definicione të dhëna nga fjalori, sepse shumë herë fjalorët nuk japin definicione substanciale apo të sakta të termit. Përdoreni definicionin nga literatura përkatëse në të cilën përmendet termi.

5. **Baraspesha në mes të dhënave nga terreni dhe shtjellimit të argumentit:** Kushtimisht, evidenca empirike që del nga puna në terren i jep antropologjisë brum për analizë interpretative, teorike, krahasimtare. Prandaj, në esenë tuaj duhet t'i shtjelloni të dhënat e gjetura (nëse keni dhe sado të pakta apo të shumta të jenë ato), me teoritë apo argumentet e rrahuara brenda fushës së antropologjisë, si në arkeologji, antropologji kulturore, e pse jo edhe disiplinat tjera.

6. **Aspekti etik:** Evidenca e mbledhur nga terreni, nga ata të cilët antropologu i interviston, vërtetohet dhe në jetën e të cilëve merr pjesë, duhet të mbrohet nga dëmi i mundshëm që mund t'iu bëhet atyre. Po ashtu, edhe evidenca e kulturës materiale si në lokalitete arkeologjike, muze, duhet të trajtohet me kujdes të madh. Kjo, për faktin se ndërhyrjet janë dëmtuese sa janë konzer-vuese. Studentët do të marrin udhëzime specifike etike në lëndët specifike. Megjithatë parimi kryesor është që hulumtuesi duhet të sigurojë se rezultati i hulumtimit të tij nuk do ta rrezikojë jetën dhe dinjitetin njerëzor të informan-tit dhe do të marrë masa që ndalojnë këtë rrezik, duke përfillur parimet e anonimitetit e konfidencialitetit në hulumtimin e tij. Edhe në gjurmimet arke-ologjike, arkeologu duhet të ndjek direktivat ligjore për ruajtjen e trashëgi-misë kulturore para, gjatë dhe pas gjurmimit të tij.

7. **Të shprehurit:** Kujdesuni që idetë tuaja të shprehen sa më qartë dhe në mënyrë sa më të rrjedhshme. Një ese e mirë ka fjali të strukturuar, logjike dhe të kuptueshme. Stërzgjatja është mungesë dhe arrogancë e të shpre-hurit. Eseja duhet të shkruhet sa më rrjedhshëm dhe sa më drejtë. Eseja duhet të shkruhet në ndjekje të traditës së mirë të shkrimit në gjuhën shqipe. Kushtoni kujdes drejtshkrimit dhe nëse citoni përkthime nga gjuhët e huaja, kushtoni kujdes të veçantë sintaksës së shqipes. Do të ishte mirë që es-enë tuaj t'ia jepni dikujt t'a lexoj para se ta dorëzoni si ese përfundimtare. Studentët shpesh e praktikojnë leximin e esesë me zë të lartë. Kjo praktikë

mund t'ju ndihmojë që t'i gjeni gabimet në sintaksë dhe po ashtu ta vlerësoni rrjedhën logjike të thurjes së mendimeve. Që asgjë mos i mungojë esesë, kjo mund t'ju ndihmojë që t'i identifikoni edhe gabimet në drejtshkrim.

8. **Citimi dhe referenca:** Puna e huaj, teksti i huaj duhet të citohet drejtë. Secilit ka tagrin apo të drejtën autoriale të punës së tij. Kur ta citosh një autor fjalë për fjalë, duhet ta bësh këtë nëpërmjet thonjzave. Pas thonjzave jepet fusnota apo referenca tekstuale.
9. **Fotografite dhe materialet ilustrative:** Eseja mund të ilustrohet me fotografi dhe materiale tjera ilustrative, të cilat shërbejnë për të forcuar argumentin e esesë. Fotografite duhet të emërohen dhe numërohen me numër 1, 2, 3, etj. Mjafon një fjali për emërtim: "Foto e Muzeut Etnologjik në Prishtinë, gusht 2018 © Filan Fisteku". Nëse fotografia huazohet atëherë duhet të theksohet autori. Nëse fotografia është e mbrojtur nga e drejta e autorit dhe e drejta e pronësisë intelektuale, atëherë duhet të merret leje paraprake para se të përdoret.
10. **Plagjiatura:** Nëse përdorni punën e dikujt tjetër pa e cituar dhe dhënë referencën e plotë, atëherë kjo është vjedhje, plagjiaturë. Pra, plagjiatura është prezantimi i ideve të dikujt tjetër si ide tuajat. Kjo tregon se autori i esesë (në këtë rast ju!) nuk ka menduar vetë dhe punën e tjetrit e paraqet si punë të tij. Nëse një ese është e vjedhur dhe dëshkohet si e tillë atëherë studenti ndëshkohet me dështim. Plagjiatura konsiderohet edhe si vetëvrasje akademike. Tema e njëjtë apo e përafërt nuk përbën plagjiaturë. Shkencat shoqërore kanë hyrë në botën e mendimit "interdisiplinar" (apo edhe "inter-tekstual") dhe gjithçka është e ndërlikuar. Premisa e një teme, qasja ndaj saj dhe metodologjia e zgjedhur përbëjnë origjinalitetin e variantit të interpretimit.
11. Sidoqoftë, njerëzit edhe gabojnë ose bëjnë plagjiaturë nga pakujdesia. Për këtë arsye po i sjellim në pah, vëmendje aspektet kryesore të sistemit të referencave.

Ekzistojnë disa sisteme të referimit: APA, Chicago-së, fusnota, etj.

Referenca sipas stilit "Chicago"

Në gjuhën shqipe së voni ka hyrë përdorimi i sistemit të referimit "Chicago style".

Ja disa udhëzime teknike nga sistemi i referencës, "Chicago style" (*Chicago Manual of Style*, 16th edition).

- Libër me një autor

Në bibliografi:

Connerton, Paul. 1989. *How Societies Remember*. Cambridge: Cambridge University Press.

Në tekst: (Connerton 1989, 23)

Në bibliografi:

Krasniqi, Mark. 2005. *Mikpritja në traditën shqiptare*. Prishtinë: ASHAK (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës)

Në tekst: (Krasniqi 2005, 53)

- Libër i redaktuar/i përgatitur

Në bibliografi:

Greenberg, Joel, red. 2008. *Of Prairie, Woods, and Water: Two Centuries of Chicago Nature Writing*. Chicago: University of Chicago Press.

Në tekst: (Greenberg 2008, 200)

- Kapitull libri

Në bibliografi:

Valdimar, T. Hafstein. 2009. "Intangible heritage as a list: from masterpiece to representation" *Intangible Heritage*, red. Laurajane Smith dhe Natsuko Akagawa (fq. 93 - 111), London: Routledge

Në tekst: (Valdimar 2009, 94)

- Ese në revistë shkencore

Në bibliografi:

Canolli, Arsim. 2017. "La culture culinaire du Kosovo: changement et continuité." *Ethnologie française*, 166, (2): 289-300

Në tekst: (Canolli 2017, 293)

- Shtypi ditor

Citatet nga shtypi ditor vendosen në fusnota si këtu në këtë fusnotë.¹

Citatet nga shtypi ditor elektronik apo ueb faqet elektronike, po ashtu nuk vendosen në bibliografi, por vetëm në fusnotë si këtu.²

- Intervista

Citatet nga intervistat nuk vendosen në bibliografi, por vetëm në fusnotë si këtu.³

Për materialet tjera shih *Chicago Manual of Style 16 edition* dhe adapto të njëjtat udhëzime.

1 Artan Krasniqi, "Lambat që ndriçojnë lidhjen me drurin", Koha ditore, 3 shkurt 2019, fq. 15

2 Artan Krasniqi, "Lambat që ndriçojnë lidhjen me drurin", Koha ditore, 3 shkurt 2019 [lexuar së fundi më 6 shkurt 2019 në: <https://www.koha.net/kulture/143129/lambat-qe-ndricojne-lidhjen-me-drurin/>]

3 Intervistë me Filan Fistekun, 42 vjeç, automekanik, Prishtinë, realizuar më 3 shkurt 2019.

Fusnota

Fusnotat përdoren si sistem tjetër i referimit, i cili preferohet edhe në studime antropologjike. Fusnotat renditen në fund të faqes. Në traditën e shkrimit akademik në gjuhën shqipe fusnotat kanë qenë i vetmi sistem i referimit deri në dekadat e fundit. Edhe në shkrimet etnografike apo etnologjike fusnotat kanë qenë sistemi kryesor i referimit. Ka shembuj në libra dhe revista etnologjike si *Gjurmime albanologjike*, *Etnografia shqiptare*, *Kultura popullore*, etj.

Nëse e përdorni sistemin e referencës së fusnotës, atëherë adoptojeni sistemin Chicago Manual of Style 16 edition, po ashtu. Bibliografia në fund të esesë shkruhet njësoj, ashtu sikurse edhe fusnota.

Ja një shembull:

Si thotë Jeremy MacClancy, tek së fundi, antropologët kanë nisur “të vërejnë pamjet që mund t’i japë studimi i bukës dhe i sjelljeve rreth bukës” ⁴

Në fusnotë vendoset: MacClancy, Jeremy. 2007. *Expressing Identities in the Basque Arena*. Oxford: James Currey Publishers, fq. 68.

Por, mund të përdoret edhe fusnota e stilit të përdorur nga shtëpia botuese (Rilindja), si stil tradicional i fusnotes në studimet shqiptare. p.sh:

Mark Krasniqi, *Mikpritja në traditën shqiptare*, ASHAK, Prishtinë, 2005, fq.10

Në rastin tuaj ju mund të zgjidhni cilëndo mënyrë të shkrimit dhe nuk nënvlerësohet cilado qoftë ajo. Por duhet të përdoret në mënyrë konsistente.

Udhëzime tjera relevante për ese

Esetë ose punimet seminarike në kuadër të programit të studimeve antropologjike (si në antropologji kulturore, arkeologji) kanë prej 1.500 deri në 3.000 fjalë, varësisht nga lënda. Tema e diplomës duhet të ketë prej 5.000 deri në 7.000 fjalë, që nënkupton edhe përfshirjen e bibliografisë, fusnotave, etj. Secila ese duhet të ketë titullin e esesë dhe emrin e autorit, në këtë rast studentit dhe numrin e ID-së. Po ashtu, në secilin punim duhet të shkruhet lënda dhe bartësi i lëndës.

Esetë duhet të shkruhen në MS Word, Times New Roman 12, me hapësirë mes rreshtave (*line spacing* 1.5), A4 me margjinë 2.5cm së paku anash.

⁴ MacClancy, Jeremy. 2007. *Expressing Identities in the Basque Arena*. Oxford: James Currey Publishers, fq. 68.

Citatet me më shumë se 50 fjalë të vendosen në citat të shkëputur nga teksti. Vizatimet dhe fotografitë duhet të shoqërohen me tekst shoqërues poshtë fotografisë, me renditje alfabetike ose me numër. Fusnotat dhe ilustrimet duhet të njihen duke iu referuar autorsisë e në raste specifike duhet të merret edhe leja për përdorimin e tyre.

Esetë duhet të procesohen në mënyrë elektronike dhe të shtypen.⁵ Eseja ideale do të ishte e gatshme për botim në ndonjë revistë shkencore.⁶ Çdo ese duhet të lekturohet para se të dorëzohet si ese përfundimtare.

Në kuadër të programit të Departamentit ekzistojnë disa lëndë (Shkrimi akademik, Kërkimi dhe shkrimi etnografik, Metodatat dhe teknikat e hulumtimit, etj) me bartësit e të cilave mund të konsultoheni për aspektet e shkrimit akademik antropologjik.

⁵ Kur ka arsye, pranohen edhe esetë e shkruara me dorë, në letër të bardhë ose të verdhë.

⁶ Këtu flitet më shumë për esetë e nivelit MA e DR. Esetë e vitit 1,2 dhe 3 BA janë esetë e para, andaj nuk pritët të botohen, por duhet të shkruhen sikur të ishin për botim.

Shtojca b)

Udhëzime etike për hulumtimin në terren, lejet për intervistë, fotografim dhe incizim

Këto udhëzime janë përgatitur duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të hulumtimit antropologjik, ku përfshihen metoda të ndryshme si: vërtetimi me pjesëmarrje, intervista, anketa, etj. Disa nga këto parimet kryesore etike janë:

- a. Hulumtuesi/antropologu duhet të ketë parasysh parimin e përgjithshëm të hulumtimit në shkencat shoqërore: antropologu duhet të marrë të gjitha masat që puna e tij hulumtuese të mos e dëmtojë subjektin e tij hulumtues, respektivisht personin e intervistuar dhe marrëdhëniet e tij me ambientin përreth.
- b. Antropologu duhet të ketë kujdes që të mos cenojë privatësinë dhe konfidencialitetin e personit të intervistuar. Andaj, antropologët zakonisht marrin leje (me shkrim) nga personat e intervistuar për punën me ta. Leja nënkupton sqarimin e përgjithshëm të përdorimit të rezultatit të punës së tij. P.sh. personi i intervistuar duhet të dijë nëse përdoret intervista e tij: "Intervista juaj do të vendosen në arkiv të Departamentit të Antropologjisë në UP, ku kanë qasje studentët dhe profesorët por edhe publiku akademik me leje nga departamenti, i cili po ashtu i nënshtrohet parimeve etike" ose "Intervista juaj do të përdoret vetëm për shkrimin e esesë sime në lëndën specifike dhe pastaj do të ruhet në arkiv të DA (ose do të fshihet pas studimit)."
- c. Antropologu duhet të marrë masa konkrete për sigurinë e të dhënave të mbledhura me pëlqim nga personi i intervistuar. Këto masa janë mbyllja me dry e të dhënave në kasafortë apo dhomë, mbrojtja digjitale me fjalëkalime të vështira, vendosja në vende të sigurta dhe konfidenciale, etj. Pra, sidomos në raste kur informacionet janë më sensitive, antropologu duhet të bëjë çmos që të sigurojë se intervistuesi nuk do të dëmtohet.
- d. Antropologu duhet të negociojë marrëveshjen me të intervistuarin dhe të pajtohet për hulumtim dhe mbledhjen e përvojave, përshtypjeve, mendimeve, kujtimeve të tyre mbi baza të informimit të mirë.
- e. Antropologu duhet të ketë parasysh se shpeshherë mendimet e të intervistuarve mund të jenë paragjyquese, fyese, denigruese e ndoshta edhe të papranueshme. Megjithatë, antropologu nuk është ideolog i ndryshimit të "mendësisë" së të intervistuarit, por vërtetues, dëgjues, pyetës e konstatues. Andaj, nuk duhet të ndërhyjë në "emancipimin" e të intervistuarit gjatë procesit të hulumtimit, por vetëm të bëjë vërtetimin, njohjen, dhe të parashtrojë pyetje dhe të marrë përgjigje.
- f. Antropologu nuk duhet të cenurojë gjuhën dhe përmbajtjen e të intervistuarit, pos në raste të gjuhës fyese e denigruese, ku vendos shenja specifike.

Sepse antropologu duhet të studiojë stereotipizimet, paragjykimet, botëkuptimet fanatike e shumë praktika e ide tjera, gjithmonë në mënyrë kritike. Këtë mund ta bëjë vetëm pasi të ketë evidenca se ato ekzistojnë.

- g. Në raste kur i intervistuari pajtohet paraprakisht me hulumtimin , por në fund të hulumtimit nuk është i kënaqur dhe nuk pajtohet, antropologu duhet të tërhiqet nga hulumtimi.
- h. I intervistuari duhet të kenë gjithmonë mundësinë të mbetet anonim dhe antropologu duhet të ofrojë atë mundësi çdo herë. Pseudonimet dhe ndryshimet e disa rrethanave tjera të jetës, si masa që merren për të parandaluar identifikimin e të intervistuarit, janë praktika të zakonshme në metodat e hulumtimit antropologjik.
- i. I intervistuari nuk duhet të shfrytëzohet ekonomikisht as të trajtohet pandershmerisht.
- j. Antropologët mund t'i përfshijnë edhe të intervistuesit në hulumtim, respektivisht t'i bëjnë pjesë e hulumtimit të tyre në terren, gjithnjë duke ndjekur parimet etike të përmendura më lartë
- k. Antropologu ka edhe obligime etike dhe profesionale ndaj sponsorëve, mbikqyrësve, kolegëve, institucionit dhe fushës së kërkimit/hulumtimit në përgjithësi
- l. Antropologu hulumtues ka përgjegjësi edhe ndaj interesit të gjerë publik të vendit ku bën hulumtime
- m. Antropologu nuk duhet të abuzojë me punën e tij etnografike në favor të ideologjive radikale.

Udhëzimet etike janë vetëm udhëzime të cilat normativizojnë disa aspekte të hulumtimit, por nuk zgjidhin vështirësit specifike që mund t'i ketë antropologu në terren. Andaj, normat etike janë norma të cilat synojnë t'i përkujtojnë antropologut dhe t'i sensibilizojnë ata, rreth dilemave dhe konflikteve potenciale gjatë punës së tyre në terren. Vendimi i hulumtuesit të antropologjisë gjithmonë duhet të varet në marrëveshje të bëra mbi baza reciproke të informimit dhe pajtimit.

Për më shumë shih: “Ethical Guidelines for Good Research Practice - Association of Social Anthropologists of the UK and the Commonwealth”⁷ dhe “Statement on Ethics: Principles of Professional responsibility” nga American Anthropological Association. ⁸

7 http://www.theasa.org/ethics/Ethical_guidelines.pdf

8 <http://www.aaanet.org/profdev/ethics/upload/Statement-on-Ethics-Principles-of-Professional-Responsibility.pdf>

Shtojca c)

Model i formës së marrjes leje për intervistë, fotografim dhe xhirim

Unë (emri i personit që jep lejen) _____

Jap lejen/pëlqimin studentit/hulumtuesit _____

të Departamentit të Antropologjisë (Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”) të përdor përmbajtjen e intervistës/fotografisë/videoingjizimit tim/e për arsye të studimit në kuadër të projektit hulumtues / programit studimor të Departamentit të Antropologjisë, për përdorim akademik nga ana e tij. Ky pëlqim jepet edhe për ruajtjen dhe përdorimin e intervistës/fotografisë/videoingjizimit në arkiv të Departamentit të Antropologjisë dhe përdorim akademik publik, me leje nga Departamenti i Antropologjisë sipas parime dhe standardeve etike.

- a) Duke përdorur emrin tim të plotë
- b) Inicialet
- c) Pseudonimin
- d) Mjegullimin e fytyrës/Ndryshimin e zërit (si masa kundër identifikimit)

Unë e jap këtë pëlqim vullnetarisht.

.....
Nënshkrimi i personit që e jep lejen

.....
* Nënshkrimi i hulumtuesit

Data dhe Vendi

* Pasi kam lexuar/dëgjuar qëllimet e projektit/esesë/temës dhe jam pajtuar me to

Departamenti i
Antropologjisë

Doracak për studentë
2020-2021

